

Psikologët
Dënimi në
çerdhe është
edukim
momental

Fq.5



**DER
STANDARD**
Kriza në VMRO-
DPMNE po
shkallëzohet

Fq.4



Vizat e
punës të
domo-
sdoshme



Pas 1 janarit 2019

Fq.4

Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3501 · e hënë, 5 nëntor 2018

15°C | 20°C

15 DEN

EDITORIAL

**Të jesh
i frikësuar nga
krtika publike!**



Ka plotë veta që më shkruajnë në Inbox për shkrimet që bëj në gazetë. Shumica prej tyre duan, në mënyrën e tyre, të solidarizohen me atë që shkruaj. Disa madje më japin edhe sygjerime shtesë se si ta mprehi edhe më tepër teshun e kritikës. Ndonjë tjetër më tregon se çfarë njohurish posedon nga fusha e tij. Nuk mungojnë edhe prej atyre që më bëjnë vërejtje se pse nuk kam qenë edhe më i ashpër në qëndrime.

Fq.2

GLOBI

**Punësimi
në Gjermani,
kërcënim për
popullsinë në
Ballkan**

Fq.17

RAJON

**Çaji i rusit
po dërgon
shqiptarët
e Kosovës
në spital**

Fq.16



KONTRADIKTAT NË MES TË REALITETIT DHE SHIFRAVE

KA RRRITJE EKONOMIKE, POR JO EDHE MIRËQENIE



Ekonomistët vlerësojnë se shndërrimi i rritjes ekonomike në mirëqenie për qytetarët, mund të arrihet vetëm me shkallët më të larta të rritje më të madh të prodhimtarisë, investimeve vendore dhe të huaja, si dhe kapaciteteve prodhuese

Fq.6

A do të kalojë pajtimi në amnisti?

Shkup, 4 nëntor - Të hënën pritet të fillojë me punë Komisioni për pajtim nacional. Për Lëvizjen Besa të Bilall Kasamit, dhe Aleancës për Shqiptarët, pajtimi nuk duhet shëndërruar në amnisti, sepse atëherë do të ishte në kundërshtim jo vetëm me shtetin ligjorë dhe atë juridik, por dhe me rekomandimet e Bahkimit Europian i cili kërkon përgjegjësi të plotë për rastin e 27 prillit, tramseton Tvm2.

"Një amnisti e natyrës të cilën po e dëgjojmë, do të ishte në kundërshtim me sistemin drejtësisë, në kundërshtim më interesin e qytetarëve të vendit, për shkak se kërkohet amnisti për bartës të funksioneve publike, persona që ndoshta më së shumti është dashtë të kujdesen për interesin public, për momentin përmendet amnestia vetëm për 27 prillin, por me siguri në prapavi fshihet edhe diçka shumë më tepër sesa kaq,



dhe unë si deputet nuk do të jem pro një iniciative të tillë" – tha deputeti i Lëvizjes Besa, Fadil Zendeli.

Fq.3

EDITORIAL

TË JESH I FRIKËSUAR NGA KRTIKA PUBLIKE!



Emin AZEMI

Ka plotë veta që më shkruajnë në Inbox për shkrimet që bëj në gazetë. Shumica prej tyre duan, në mënyrën e tyre, të solidarizohen me atë që shkruaj. Disa madje më japin edhe sygjerime shtesë se si ta mprehi edhe më tepër t'atë të kritikës. Ndonjë tjetër më tregon se çfarë njohurish posedon nga fusha e tij. Nuk mungojnë edhe prej atyre që më bëjnë vërejtje se pse nuk kam qenë edhe më i ashpër në qëndrime.

Të gjithë këta që më shkruajnë në Inbox, i konsideroj qëllimshëm në përpjekjet e tyre për të thënë të vërtetën. Mirëpo e vërteta duhet thënë publikisht. Pse ka nevojë dhe deri kur ka nevojë që ne të fshihemi, të paktën që të shprehim një solidarizim të hapur me ndonjë qëndrim të guximshëm intelektual të kujtëdo. Nga kush frikësohemi?

Dikur njerëzit frikësoheshin më pak. Ose, bënin përpjekje që frikën ta lënë si opsion të fundit në shprehjen e çfarëdo lloj pakënaqësie. Shumë prej atyre që nuk deshën të bashkëjetojnë me frikën, u futën nëpër burgje, u diferencuan, ikën në mëgrim.

Po sot? Çka është gjithë ky ngurrim? Prej kujt frikësohen njerëzit? Cila parti politike mund të ndëshkojë ndonjërin që shpreh një mendim të lirë?

Pse nuk flasim hapur, nëse ka apo s'ka sot censurë të mendimit publik? Nëse ka, ta themi se kush po na cenzuron. Nëse s'ka, atëherë pse heshtin ata që duhet të flasin.

Ne edhe në të ardhmen do të shkruajmë me njëri tjetrin letra interne, por qëllimi nuk është që mendimin intelektual (nëse ka të tillë) ta reduktojmë në suaza të ngushta. Prandaj, jo rastësisht nuk është thënë se një dije nuk është tamam dije, nëse ajo nuk transmetohet.

Çka po transmetojmë ne sot? Si po i edukojmë gjeneratat e reja?! A po iu themi edhe atyre që të heshtin?! A po i trajtojmë edhe ata të jenë poltronë të autoriteteve politike?! A po përgatisim kuadro që në vend të diplomës universitare, të shfaqin poltrinizmin e tyre për të qenë më të pranueshëm nga aparatçikët partiakë?!

Krtika publike është më e shëndetshme, se çfarëdo lloj poltronizmi. Kritika publike, kur është e bazuar në analiza e argumente, mund të jetë terapia më efikase për një shoqëri, se sa çfarëdo lloj tifozllëku politik. Sartri në Francë, Habermasi në Gjermani, Eco në Itali, Saramago në Portugali, Borhesi në Argjentinë, jo gjithmonë u pajtuan me politikën e qeverive të tyre, por askush më shumë se ata nuk treguan përkushtim atdhedashur ndaj vendit të tyre.

Pse ne ankohe mi në partitë politike se ato gjoja po na e cunjojnë mendimin e lirë, kur, për hirë të vërtetës, ne jemi bërë autonensorët më të mëdhenj! Ne drejtojmë media, ne menaxhojmë universitete, ne veprojmë nëpër institucione dhe nuk ka ndodhur që dikujt t'i ketë pëshpëritur në vesh ndonjë ndalesë publike dikush nga partitë politike.

Të paktë janë ata që intimisht nuk pajtohen me atë që shkruan në gazetë. Por, sikur për të njejtën temë të organizohet një debat publik, të njejtiti nuk kanë guximin të debatojnë hapur. Ata i marrin ftesat për debat, por as nuk kanë guximin të përgjigjen se vijnë apo nuk vijnë në debat.

Pse?!

Si është e mundur?!

Në të ardhmen do të duhej të merremi më shumë me këtë fenomen. Me fenomenin e frikës (më tepër abstrakte) që njerëzit e kanë instaluar në kokat e tyre. Apo, ka pasoja të heshtura, nëse shprehim një mendim publik, për të cilat duhet folur hapur. Edhe për këtë, pra, duhet folur. Kush janë ata që hakmirren tinëz ndaj kritikësve publike dhe a ndodhë që të shantazohen (kushtëzohen) njerëzit duke e blerë njëfarë "pakti të mossulmit" përmes anëtarësimit në ndonjë bord apo komision shtetëror. Kush mund ta dijë...Gjithçka mund të ndodhë...

Vareni fjalën "demokraci" në bolet tuaja!

"Mos e digjni filan zyrë udhëtimi pasi atë e ka një "vorioepriot" atë, po, digjeni një tjetër që është ngjitur me të, e ka një shqiptar.

Jam e sigurt se nëse do dilja dje t'ju rrembeja flamurin tim, për mos t'ju lejuar ta digjni e ta perulni, do me kishit vrare edhe ju.

Fshini bythen me historinë tuaj! Vareni fjalën "demokraci" në bolet tuaja!

Kokëtrashë e të pabesë!

Është një dhimbje më e thellë e një hije më e zeze se kjo. Është ajo e të qenit i pavlerë, i papeshë, në harresë, kështu si jemi ne këtu që nuk na llogarit askush para se të veprojnë si adoleshent që luan videogame. Është turp e faqa e zeze për të dy anët që tregojnë botërisht se meritojnë fatin e tyre të deritanishëm.

Më vjen turp për llogari te tyre!", ka shkruar një status në Facebook, poetja Brikena Qama që jeton në Athinë.

Raporti im me gazetarët

"Nuk e kuptoj pse disa portale dhe gazeta duan prononcime nga unë, përdherisa janë fare të pakta temat që nuk i trajtoj në postimet e mia?! Ka kohë që jam duke injoruar me qëllim çdo pyetje që kërkon prononcimin tim, për dy arsye kryesore.

E para, gazetarët duhet të jenë më diligjentë dhe më të vyeshtë që vetë t'i shtjellojnë temat e ndryshme në vend që t'i mblaqisin fjalët e mia, apo të dikujt tjetër për ta bërë një copë shkrim.

Dhe e dyta, shumica e gazetarëve që më kërkojnë prononcim, më bëjnë pyetje sugjестive duke mos lënë shtek tjetër pos që unë me përgjigjet e mia të dalë aty ku duan ata dhe shefat e tyre! Me fjalë tjera, këta gazetarë me logjikë mercenare, duan që edhe unë t'i mbyll sytë dhe ta ndjek të njëjtën udhë, kështu që ata në mënyrë përfide të më përdorin për qëllime kryesisht klanore, private dhe meskine. Jo, këtë nuk mund ta bëjnë mua!

Sidoqoftë, nuk ka asnjë shkrim që e publikoj në murin tim në facebook dhe që nuk qëndroj pas tij pa marrë parasysh se kush e boton atë, qoftë ai edhe një portal i Beogradit. Sikur të frikësohesha nga fjala ime dhe nga abuzimi që të tjerët bëjnë me të, unë nuk do t'i hyja kësaj pune fare.

Por, dua të jem i sinqertë se nuk më vjen mirë aspak nga abuzimet që përditë gazetaret tona bëjnë me postimet e mia, duke nxjerr tituj senzacionalë e moto absurde që nuk përkujtojnë askund me argumentet dhe mendimet e mia, apo thjesht me përmbajtjen e postimeve që bëj. Një gjë që kundër shqiptarëve e bënte dikur shtypi i verdhë i Beogradit, sot po e bën shtypi i verdhë shqiptar i një grupi kundër grupit tjetër.

Unë nuk kam ndonjë masë tjetër mbrojtëse nga këto abuzime dhe manipulime që bëhen me emrin tim dhe me fjalën time, pos që t'i lus të gjithë lexuesit gjithandëj ku jashtë kontrollit tim botohen postimet e mia, t'i lexojnë ato deri në fund, sepse mediat janë të obliguara që përveç titujve dhe motove që ato nxjerrin në fillim të shkrimit, të botojnë në vijim tekstin integral të çdo postimi", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtari dhe mjeku, Liri Loshi.

MEDIA Citate

Presidenti Meta tregon arsyet pse nuk e dekreton Sandër Lleshin

Presidenti Ilir Meta, ende nuk ka firmosur dekretin për ministrin e ri të Brendshëm Sandër Lleshi.

Kreu i shtetit pohoi për mediat se nuk do të hedhë firmë për dekrete formale, aq më tepër për një detyrë të tillë që kërkon përgjegjëshmëri maksimale.

"Do gjej kohën e duhur, për të marrë vendimin e duhur. Presidenti ka për detyrë për të ushtruar të gjitha detyrimet kushtetuese për çdo propozim që i bëhet. Nuk mund të hedh firmë për dekrete formale e aq më tepër për një detyrë të tillë që në momentin aktual, kërkon përgjegjëshmëri. Di të marr vendimet e mua, pa u ndikuar nga askush, as nga orët dhe sekondat. Kushtetuta është shumë e qartë, presidenti ka përgjegjësi për çdo firmë që hedh. Ua kam thënë të qartë kam bërë punën time institucionale, kam bërë përpjekjet e mia, kam qenë mjaft bashkëpunues me institucionet dhe personat e interesuar për këtë çështje, dhe unë i marr vendimet e mia pa i ndikuar nga askush. Më duket se Kushtetuta është shumë e qartë, presidenti ka përgjegjësi për çdo firmë që hedh."

Meta shtoi se Shqipria ka sfidë luftën kundër krimit të organizuar dhe të gjitha prioritetet lidhen me këtë çështje. Ndaj askush sipas tij të mos mendojë se presidenti mund të firmosë vetem ne menyre formale letrat që i sjellin. "Lufta ndaj krimit të organizuar ka një rritje të ndikimit në jetën politike, dhe sfida ndaj saj nuk është vetëm përgjegjësi e qeverisë dhe parlamentit por edhe e presidentit. Ministri që dha dorëheqjen Xhafaj, tregoi një vullnet për të ecur në këtë drejtim pavarësisht nga rrethanat e komplikuara, por në çdo rast kjo është betejë e të gjithëve. Përgjegjësit janë shumë të rëndësishme për të mos iu bindur askujt që do të përpiqet të ndikonte politikisht në policinë e shtetit".

Gjithashtu Meta ka theksuar se nuk ka njohje personale me Lleshin, dhe se i siguron të gjithë se askush nuk e detyron atë të firmosë një emër jashtë bindjes së tij. Ndërkohë mbetet për tu parë se çfarë do të vendosë Ilir Meta, por nëse do ta refuzonte dekretimin e Lleshit, ky do të ishte rasti i parë që presidenti nuk dekreton një ministër.


(Vizion Plus, 4 nëntor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUNDODHET QYTETI I HUMBUR I ATLANTIS?

Kërkimet për qytetin e humbur të Atlantit asnjëherë nuk janë ndalur që nga koha e filozofëve grekë, por askush nuk ka arritur të gjejë se ku gjendet. Por një teoricienti i konspiracionit beson që më në fund e ka gjetur qytetin e lashtë. Joy Lovers beson që qyteti i vjetër gjendet në shkretëtirë Saharas. Ai beson që qyteti është i lokalizuar afër Ouadane, në qendër të Mauritaniës, në strukturën Richat, që cilësohet si syri i Saharas.

Syri i Saharës ka një diametër prej 23.50 km, kurse sipas të dhënave për Atlantit, qyteti kishte një diametër prej 23.49km.



Çështjen e pajtimit kryeministri Zaev deri më tani e ka potencuar disa herë, por, sipas opozitës shqiptare, me këtë tentim kryeministri Zaev mund të pajtojë VMRO-në me LSDM-në por jo edhe shqiptarët

KOMISIONI PËR PAJTIM NACIONAL

A DO TË KALOJË PAJTIMI NË AMNISTI?



Shkup, 4 nëntor - Të hënën pritet të fillojë me punë Komisioni për pajtim nacional. Për Lëvizjen Besa të Bilall Kasamit, dhe Aleancës për Shqiptarët, pajtimi nuk duhet shëndërruar në amnisti, sepse atëherë do të ishte në kundërshtim jo vetëm me shtetin ligjorë dhe atë juridik, por dhe me rekomandimet e Bahkimit Europian i cili kërkon përgjegjësi të plotë për rastin e 27 prillit, tramseton Tvm2.

“Një amnisti e natyrës të cilën po e dëgjojmë, do të ishte në kundërshtim me sistemin drejtësisë, në kundërshtim me interesin e qytetarëve të vendit, për shkak se kërkohet amnisti për bartës të funksioneve publike, persona që ndoshta më së shumti është dashur të kujdesen për interesin public, për momentin përmendet amnestia vetëm për 27 prillin, por me siguri në prapavi fshihet edhe diçka shumë më tepër sesa kaq, dhe unë si deputet nuk do të jem pro një iniciative të tillë” – tha deputeti i Lëvizjes Besa, Fadil Zendeli.

Deputeti i ASH-së, Syrjia Rushi-

ti pohon se me këtë tentim kryeministri Zaev mund të pajtojë VMRO-në me LSDM-në por jo edhe shqiptarët. Për Aleancën ky qëndrim i kreut të ekzekutivit është i paparueshëm sepse në Maqedoni ekziston nevoja për pajtim ndër-etnik mes shqiptarëve dhe Maqedonasve.

“Kryeministri i hodhi këtë si mundësi për ti joshë deputetët e VMRO-DPMNE-së për ti votuar ndryshimet kushtetuese. Dilema kryesore është këtu se kush me kë

duhet të pajtohet. Kemi ndërguar koluareve të Parlamentit që do të pajtohet VMRO-DPMNE-je dhe LSDM-ja, atëher pyetja shtrohet se çka kërkojnë këtu shqiptarët, aq më tepër që Kryetar i Komisionit hipotetik që do të merret me çështjen e pajtimit është Kryetari i Kuvendit, pra një shqiptarë. Ne jemi të mendimit se në Maqedoni ka nevojë për pajtim, por ai pajtim të jetë ndër-etnik” – tha deputeti i ASH-së, Syrjia Rushiti, përcjell Tvm2.

Çështjen e pajtimit kryeministri

Zaev deri më tani e ka potencuar disa herë, së fundmi pas vendimit të Qeverisë për miratimin e tekstit të propozim amendamenteve, si një mundësi e cila do të kontribuonte në zhvillimin e demokracisë dhe pluralizmit politik, madje edhe në rritjen e besimit ndaj punës së institucioneve në rradhë të pare atë të gjyqësorit si një ndër postulatet kryesore për te cilat Maqedonia duhet të jep rezultate pozitive para autoriteteve të Bashkësisë Ndërkombëtare.



Prej sot fillon vaksinimi kundër gripit sezonal

Shkup, 4 nëntor - Në të gjitha Qendrat e shëndetit publik në vend, të hënën fillon vaksinimi kundër gripit sezonal. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, informoi se për këtë vit janë siguruar 41.000 doza të vaksinave. Për herë të parë këtë vit, Ministria ka blerë 28.000 doza vaccine, të cilat janë pa pagesë për personat mbi 65 vjeç me një pension prej më pak se 14.480 denarë, domethënë me një pension mesatar dhe nën mesatar, si dhe për ata që nuk kanë pension. “Kemi blerë vaksinë me katër valenta, e cila është më e reja, me cilësi të lartë, dhe mbron kundër katër lloje të gripit dhe është rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Agjencia Evropiane Shëndetësore. Vaksinat janë blerë nga kompania farmaceutike franceze “Sanofi Paster”. Këtë vit ne ndihmojmë qytetarët që kanë më shumë nevojë për vaksinim. Vaksinimi nuk është i detyrueshëm, por është e rekomanduar për njerëzit mbi 65 vjeç, si dhe sëmundje të tjera kronike, si dhe profesionistëve të shëndetit dhe të tjerëve me rrezik shëndeti” – tha ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe. Bëhet fjalë për 130.000 doza të cilat i kanë blerë Qendrat për Shëndet Publik, ndërsa çmimi i tyre është 650 denarë. Ministria e Shëndetësisë gjatë sigurimit të vaksinave ka arritur çmimin më të ulët, me çka ka kursyer rreth 75 mijë euro.

Shqiptarët po bashkohen për të kërkuar të drejta



Shkup, 4 nëntor - Shqiptarët në Maqedoni nisën një fushatë në rrjetet sociale, me qëllim që të ndërgjegjësojnë politikanët që të njihen si shtet-formues, teksa vendi po punon për ndryshimet kushtetuese, në bazë të Marrëveshjes së Prespës.

Në qendër të fushatës “Don't you 20% me, I'm Albanian” (Mos më quaj 20%, unë jam shqiptar), janë kërkesat për partitë politike që të japin kontributin e tyre dhe

që përmes amendamenteve të propozojnë në Parlament ndryshimin në kushtetutë të emërimit “bashkësia etnike mbi 20%”, të cilin e quajnë term fyes, dhe zëvendësimin e tij me emërtesën “shqiptarët”.

Fushata në Facebook gjithashtu synon edhe në zëvendësimin në pjesët ku thuhet “gjuha e bashkësisë etnike mbi 20%” dhe në vend të saj të jetë “gjuha shqipe”.

Bekteshi: Çdo vend mban përgjegjësinë bazë për zhvillimin e tij ekonomik

Shkup, 4 nëntor - Në Shkup u mbajt konferenca shkencore me temë “Drejt zhvillimit të qëndrueshëm”, organizuar nga Universiteti “Nënë Tereza”-Shkup, në fokusin e të cilës ishin sfidat me të cilat po përballen shtetet dhe përkrahja e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë konferencë mori pjesë edhe ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi.

“Çdo vend mban përgjegjësinë bazë për zhvillimin e tij ekonomik

dhe shoqëror dhe në këtë drejtim nuk mundet dhe të mos theksohet roli i politikave të cilat zbatohen në nivel kombëtar, si dhe në resurset vendore dhe strategjitë zhvillimore. Me uljen e paqëndrueshmërisë politike në Republikën e Maqedonisë dhe me forcimin e shumicës parlamentare, qartë po lehtësohet implementimi i reformave të planifikuara në pesë shtylla: rritje ekonomike, reforma, institucione në shërbim të qyte-

tarëve, një shoqëri për të gjithë dhe shtylla e fundit e interesave tona strategjike – Anëtarësimi në NATO dhe Bashkimin Evropian. Me këtë tashmë ka ndryshuar edhe kursi ekonomik i shtetit”, u shpreh ministri Bekteshi.

Në konferencë u tha se një zhvillim i qëndrueshëm paraqet thirrje globale për aksion me qëllim që të mposhtet varfëria ekstreme, të sigurohet një ardhmëri e sigurt dhe t'u mundësohet të



gjithë njerëzve që të jetojnë në paqe, të gëzojnë drejtësi të cilat njëherësh përfaqësojnë vazhdimësinë e qëllimeve mijëvjeçare të Kombeve të Bashkuara të cilat shkojnë dhe një hap më tej për-

mes konfirmimit të prioriteteve dhe qëllimeve të reja (ndryshimet klimaterike, konsum i qëndrueshëm, paqe, drejtësi) në betejën kundër të gjitha formave të varfërisë.

DER STANDARD: KRIZA NË VMRO-DPMNE PO SHKALLËZOHET

Kriza në partinë opozitare nacionale-konservatore VMRO-DPMNE po shkallëzohet, shkruan gazeta "Der Standard" austriak në edicionin e saj të vikendit, duke u bazuar në zhvillimet e fundit të kësaj partie. VMRO-DPMNE nga viti 2006 deri 2007 ishte në pushtet para se ta kaplojë kriza për shkak të keqpërdorimit sistematik të funksioneve, por edhe pas dy viteve, nuk është reformuar për të nisur një fillim të ri. Ish kryeministri Nikolla Gruevski më së voni më 8 nëntor duhet të paraqitet për të mbajtur 2 vjet burg për blerjen ilegale të një Mercedesi të shtrenjtë. Për të njëjtin rast, është dënuar edhe ish ministria e Punëve të Brendshme, Gordana Jankuloska. Ajo e ka të pamundur që të largohet nga Shkupi, për arsye se duhet të lajmërohet në gjykatë për shumë raste të tjera. Javën që shkoi gjykata ngriu pronën e 69 objekteve në pronësi të kësaj partie, duke përfshirë edhe selinë kryesore në Shkup. Gjykatësit janë duke kryer hetime për pastrim të parave, për arsye se partia ka dekla-




ruar që do të shet pasuri të patundshme. Gruevski është i dyshuar për pranimin e donacioneve të paligjshme prej miliona dollarësh dhe investimin e tyre në blerje të pasurive të patundshme. VMRO-DPMNE është thellësisht e përcarë, jo vetëm për vepra të krimit, por edhe për pozitën e saj ideologjike të politikës së jashtme. Kjo u shfaq së fundmi në votimin për marrëveshjen për ndryshim të emrit të arritur me Greqinë në Parlament, shkruan "Der Standard".

Udhëheqja aktuale e partisë nën udhëheqjen e Hristijan Micko-

skit ka kundërshtuar emrin e ri të shtetit, "Maqedonia Veriore", i cili është kusht për anëtarësimin e vendit në NATO, shkruan gazeta. Deputetët tash më janë të përjashtuar, por në VMRO-DPMNE ekziston një krah që përkrah politikën pro-perëndimore. Nga ky krah, tetë persona kanë votuar për marrëveshjen me emrin më 19 tetor, e cila siguroi shumicën e duhur e dy të tretave në parlament. Por, tani edhe disa përfaqësues tjerë të VMRO e kritikuan udhëheqjen e partisë, e që do të ndikojë në izolimin e saj nga politika anti-perëndimore, që është

vërejtur sidomos në marrëdhëniet me partinë si motër, Partia Popullore Evropiane (PPE). Në fakt, EPP e mbështeti zbatimin e marrëveshjes për emrin me Greqinë. Por edhe brenda Komisionit Evropian, kzi-ton pakënaqësi nsaj VMRO-DPMNE-së për faktin se ajo u mobilizua kundër marrëveshjes së Prespës. Pas ndryshimeve kushtuese që duhet të hynë në fuqi në janar, pritet ratifikimi i marrëveshjes në Parlamentin grek para zgjedhjeve parlamentare në vend", shkruan "der Standard", transmeton gazeta KOHA.



Ende nuk është mbyllur hetimi për vdekjen e dëshmitarit të PSP-së

Shkup, 4 nëntor - Megjithëse në qershor të vitit 2016, Prokuroria e Shkupit konfirmoi se piktori akademik 40-vjeçar, Kosta Krpaç, dëshmitar i PSP-së dhe ish-drejtor i kompanisë "Finzi", ka kryer vetëvrasje, por hetimi për këtë rast ende është i hapur, konfirmojnë për "Makfax" nga Prokuroria Themelore Publike në Shkup.

Nga Prokuroria thonë se janë ende në pritje të regjistrimeve për vdekjen misterioze në Kapishtec të Shkupit të ndodhur para 2 vjetëve, që të konfirmohet nëse dikush e ka kërcënuar Krpaçin.

"Prokurori publik kompetent i Prokurorisë Publike për ndjekje të krimit të ndërlidhura dhe që rrjedh nga përmbytja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve kërkoi regjistrimet nga deklaratat e Kosta Krpaç të dhëna para kësaj prokurorie për të përcaktuar nëse ai ka përmendur në deklaratën se dikush e ka kërcënuar dhe nëse ka theksuar emra konkret. Përgjigja ndaj kësaj kërkesë nuk ka arrihur në Prokurorinë Publike në Shkup", thonë nga Prokuroria. Nga Prokuroria Speciale Publike nuk u përgjigjen pyetjeve nëse nga regjistrimet kishte ardhur deri tek njohuri të reja dhe pse dëshmia e Krpaç nuk iu është dorëzuar kolegëve të tyre nga Prokuroria e Shkupit. Jozyrtarisht, në procedurën para hetimore për vdekjen e Krpaç, janë marr informacione të reja sensitive

NJOFTIM I AMBASADËS GJERMANE NË SHKUP

Edhe pas 1 janarit 2019, vizat e punës të domosdoshme

Ambasada gjermane në Shkup kumtoi se nuk janë të sakta raportimet për ligjin e ri që do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2019 me të cilin qytetarët nga vendet të cilat nuk janë anëtare në Bashkimin Evropian do t'u mundësojë të punësohen në ndonjë shtet të Unionit nën kushtet e njëjta si qytetarët e vendeve anëtare të BE-së.

"Qytetarëve të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së u nevojitet sikur deri tani, ashtu edhe pas 1 janarit të vitit 2019, vizë pune valide në Gjermani. Kërkesa për vizë mund të dorëzohet vetëm në Ambasadën gjermane në Shkup dhe vetëm atje jepen vizat", saktësojnë nga Ambasada.



Përfaqësia diplomatike gjermane në Maqedoni tregon edhe njëherë se ajo nuk bashkëpunon me ndërmjetësues ose agjenci.

"Përmes tyre nuk mund të merret as termin më herët ose të përshpejtohet procedura e vizave. Taksa për vizë arrin sipas rregulla-

ve 75 euro dhe paguhet me para në dorë dhe vetëm në euro, direkt në sportelin e vizave kur dorëzohet kërkesa për vizë. Taksa të tjera nuk ka në Repartin e vizave. Marrja e formularëve dhe e udhëzimeve, si dhe caktimi i terminit janë falas", shtojnë nga Ambasada Gjermane.



LSDM: Gruevski ishte i gatshëm t'i shpenzonte 20 milionë euro për rrotën panoramike

Shkup, 4 nëntor - Kryerësi i krimit, Nikolla Gruevski, ishte i gatshëm të shpenzonte pothuajse 20 milionë euro, para të qytetarëve duke fryrjes së fondeve nga institucionet publike për të ndërtuar një rrotë panoramike në Vardar, thuhet në një reagim të LSDM-së. Për të përmbushur dëshirat personale të Gruevskit, plani i detajuar urban u ndryshua për të ndërtuar rrotën panoramike, qëllimi i vetëm i së cilës ishte të shihej krimi i projektit "Shkup 2014".

Përveç milionave të shpenzuara për ndërtimin e saj, është rrezikuar rryma natyrore e Vardarit dhe eko-sistemi i lumit. Nga LSDM akuzojnë edhe Hristijan Mickoskin se është dora e zgjatur e mentorit dhe shefit të tij, Nikolla Gruevski, ku shtojnë se udhëheqësia antiperëndimore e OBRM-PDUKM-së dhe Hristijan Mickoskit është kundër BE-së dhe NATO-së.

Kërkohet trajtimi human i kafshëve

Shkup, 4 nëntor - Nën moton "Drejtësi për kafshët", të dielën nëpër rrugët e Shkupit u zhvillua një demonstrim paqësor i revoltës së aktivistëve për të drejtat e kafshëve, të cilët kërkuan nga autoritetet lokale dhe ato qendror një qasje më serioze ndaj kafshëve endacake. Përveç aktivistëve nga sektori civil, kësaj proteste në marshimin nga Parlamenti-Qeveria e deri te zyrat e Qytetit të Shkupit iu bashkëngjitën shumë qytetare.

Kjo proteste u mbështet edhe nga një numër i konsiderueshëm i estradës maqedone, të cilët nëpër rrugët e tyre protestuan së bashku me kafshët tyre shtëpiake

dhe njëkohësisht duke i mbajtur parullat në dorë "Në Drislla e varrosët ndërgjegjen tuaj", "Vrasje nuk është selektim natyror", "Gjoha për kafshët braktisura", "Na e jepni Vardarishten", e kështu me radhë.

"Jemi të lodhur nga munges e idejeve. Kërkojmë që qëndrën për trajtimin e kafshëve endacak ta drejtojmë ne, përfshi edhe gjitha qendrat tjera të kësaj natyre në vendin tonë. Cdo komunë e ka nga një 'Vardarishte'. Shpesh herë i kemi ftuar njerëzit që nuk duan kafshë nëpër rrugë. As ne nuk duam. Duam ato të kenë shtëpi. Nuk duam ato të maltrohen nëpër



rrugë, të sulmohen dhe keqtrajtohen (helmohen). Për këto veprim askush nuk përgjigjet. Duam zbatimin e ligjeve. Kërkojmë kon-

troll mbikëqyrës më rigoroz. Njerëzit e vërtetë në vendet e vërteta", tha njëra prej aktivisteve për të drejtat e kafshëve.

Pavarësisht paralajmërimeve dhe thirrje për ngritjen e vetëdijes qytetare gjatë pjesëmarrjes në komunikacionin, një pjesë e konsiderueshme e shoferëve dhe këmbësorëve pasi të bëhen pjesë e aksidenteve në rrugë, para organeve të rendit mbrohen me arsyetime banale. Për këtë qëllim KRKS, apelon që arsyetime banale të lihen anash dhe vozitësit ti qasen me seriozitet prezencës në rrugët e vendit dhe më gjërë

KULTURA NË KOMUNIKACION

"MOS U ARSYETO"



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 4 nëntor- "Mos u arsyeto", është fushata e radhës të cilën është duke e zhvilluar Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion (KRKS). Arsyetime me të zakonshme të shoferëve që marrin pjesë në aksidentet e komunikacionit, sipas analizave dhe hulumtimeve të KRKS-së, janë shpejtësia për të arritur në punë, për në takime apo ato të llojit se kanë shpejtuar për të zënë ngjyrën e gjelbër në semaforin e radhës. Në rrugëti-

min e tyre për të ngritur vetëdijen dhe përmirësuar kulturën në komunikacionin rrugor, drejtuesit e KRKS-së kanë konstatuar se asnjë arsyetim nuk është i qëndrueshëm, në kohë kur e rrezikon ta humbasësh jetën tënde apo të ndonjë pjesëmarrësi tjetër në rrugë.

Në numërimin e arsyetimeve shtesë që më shpesh i japin shkaktarët e aksidenteve në komunikacion, siç njoftojnë drejtuesit e Këshillit në fjalë, lidhen me bisedat e tyre në telefon, shpejtësinë e madhe, vozitjen nën ndikimin e alkoolit apo arsyetime të ngjash-

me të cilët aspak nuk i japin "legjitimim" aksidentet.

"Disa prej shoferëve dinë të thonë 'vendim i imi është që mos të shfrytëzoi rripin e sigurisë në veturë apo 'vendim im është të mos ndalem në vendkalimet për këmbësor'. Këto janë pjesë e arsyetimeve banale, respektivisht kështu lind dilema dhe parashtrahet pyetja se vallë është vendim yt që të marrish pjesë në aksident komunikacioni i cili mund të kalojë me pasoja tragjike apo lëndime të rënda trupore. Vlerësojmë se pjesëmarrja e sigurisë dhe e përgjegj-

shme në komunikacion, nuk janë e drejtë e zgjedhjes, por obligim që nuk pranon arsyetime dhe keqardhje. Fushata 'Mos u arsyeto' ngjashëm si fushatat e deritanishme synon ta ngritë vetëdijen për pasojat e mundshme nga aksidentet në komunikacion te çdo individ. Nëpërmjet edukimit për rëndësinë dhe nevojën maksimale të rritjes së përgjegjësisë në kohën kur gjendemi në komunikacion, besojmë se do të rritet niveli i disiplinës kur bëhet fjalë për respektimit e rregullat dhe obligimeve", thonë nga KRKS.

Angazhimet e vazhdueshme të institucioneve shtetërore për zvogëlimin e aksidenteve tragjike në komunikacion, ndonëse nuk japin rezultate të mëdha, megjithatë statistika e deritanishme të KRKS, thonë se për nëntë muajt e parë të vitit 2018 numri i këtyre aksidenteve është zvogëluar për dhjetë për qind. Fatkeqësisht, sipas tyre arsyetime e pa baza janë bërë shprehje e keqe e shoferëve që marrin pjesën në aksidente e përditshme në komunikacion. Ndryshe, krahas shoferëve të pandërgjegjshëm fajtor kryesor për shkaktimin e aksidenteve në rrugë janë edhe këmbësor. Me mos respektimin e vendeve të shënuar për këmbësor, kjo kategori e qytetarëve gjatë viteve të fundit ka pësuar lëndime të rënda trupore, me çka vetëm gjatë vitit 2017 në pjesë të ndryshme të Maqedonisë, jetën e kanë humbur 34 këmbësor. Këto statistika që mund të gjenden në raportet e Ministrisë për Punë të Brendshme, flasin se numri i këmbësorëve të lënduar për vitin e kaluar ka arritur deri në 1 mijë qytetar.

NDËSHKIMI I FËMIJËVE NË ÇERDHE

PSIKOLOGËT: DËNIMI ËSHTË EDUKIM MOMENTAL

Dënimi është forma më e keqe për edukimin e një fëmijë, ai është momental dhe mund ti qetësoj fëmijët për disa minuta, mirëpo për këtë psikologët vlerësojnë se duhet të punohet në vazhdimësi me fëmijët duke iu folur vazhdimisht që të edukohen drejtë

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 2 nëntor- "Fëmijët nuk duhet të dënohen në çerdhe, por ata duhet të disiplinohen", kështu u shprehën pedagogët dhe psikologët për gazetën KOHA në pyetjen se a duhet të dënohen fëmijët në çerdhe. Shpeshherë prindërit ankohen se fëmijët e tyre keqtrajtohen në çerdhe, duke i dënuar me mbyllje nëpër komodina, për ti frikësuar, por në shumicën e rasteve ata ndëshkohen edhe fizikisht. Gjatë muajve të fundit kishte shumë raste të tilla, ku prindërit



kërkuan edhe instalimin e kamereve nëpër kopshte për fëmijë.

Drejtoresha Rabije Loku nga kopshti "Fidani" në Shkup, vlerëson se fëmijët nuk duhet të dënohen por duhet të edukohen duke iu dhënë shpjegime mbi gabimin e bërë. Assesi nuk duhet të përdoret dhunë sepse kjo ndikon në formësimin dhe personalitetin e fëmijës, me ç'rast mund t'i jepet një imazh i keq. "Fëmija duhet ta ndiejë se është i dashur, ne duhet ti edukojmë në atë mënyrë që të jemi model i mirë për ta, nëse ne përdorim dhunë dhe fjalë fyese do të jemi fotografi e keqe për fëmijët.

Dënimi është mënyra më e keqe dhe jo efikase për të edukuar fëmijët, sepse duke parë sjelljet e të tjerëve ata ndërtojnë identitetin e tyre", tha Loku.

DËNIMET KRIJOJNË EFEKTE KONTRAPRODUKTIVE

Ndërsa psikologët theksuan se kur prindërit dhe njerëzit e tjerë nga rrethi i afërt i dënojnë fizikisht dhe i drejtohen me fjalë se "ti je i keq", "nuk je i zgjuar", "nuk je i mençur", "nuk je i aftë" dhe të tjera ata fillojnë vërtetë ta besojnë këtë. Dënimet tek fëmijët krijojnë frikë, ndërsa frika tek fëmijët nuk nxit

as respekt e as edukim të mirëfilltë.

"Tek fëmijët nuk duhet praktikohet dhuna dhe as nuk duhet të ketë ndonjë vijë të kuqe apo limit për këtë, por duhet të bisedohet dhe t'u shpjegohet se cila është mënyra e drejtë dhe pse nuk duhet të përsëritet një gjest i caktuar, sepse vetëm në këtë mënyrë rrenjësisht mund të zgjedhim problemin. Nëse dënohet një fëmijë disa minuta, ai prapë mund ta përsëris gabimin dhe ky është edukim momental, ne duhet që të ulemi të bisedojmë me fëmijën në këtë mënyrë edhe të tjerët do të marrin mësim", tha për gazetën KOHA psikologja Aneta Brestovac, nga kopshti i fëmijëve "Cruvakapa" në Shkup. Brestovac shtoi se duhet fillimisht të detektohet problemi sepse shumë fëmijë mund të vijnë nga familje të cilat kanë probleme, këto probleme fëmijët i manifestojnë në formë të ndryshme njëra ndër to është duke shkaktuar rrëmujë dhe probleme ndaj fëmijëve të tjerë.

"Nëse një fëmijë përsërit problemin duhet të kontaktojmë prindërit që ta ndihmojmë se ku qëndron problemi. Me fëmijët duhet të punohet në vazhdimësi sepse me anë të një bisede nuk mund të zgjidhet

problemi apo ti edukojmë ata, rol të madh luan prindi dhe informatat që ai i jep", tha Brestovac

ÇERDHE TËNË EFEKT POZITIV NË SJELLJET E FËMIJËVE

Rezultatet nga hulumtimet e fundit në Francë konstatuan se çerdhet kanë efekt pozitiv. Studimet thonë se fëmijët që shkojnë në çerdhe janë më të shoqërueshëm në krahasim me fëmijët që nuk shkojnë.

Studimi i kryer nga Universiteti i Francës "Soborna", ka ndjekur zhvillimin emocional të 1500 fëmijëve që nga lindja deri në moshën tetë vjeçare nëpërmjet anketa të plotësuar nga prindërit. Ndikimi pozitiv tek fëmijët nuk ishte vetëm gjatë kohës që shkonin në çerdhe por në plan më afatgjatë këta fëmijë manifestuan më pak probleme në sjellje dhe më pak probleme sociale në adoleshencën e hershme. Kopshti i fëmijëve në vitet e para të jetës mund të përmirësojë sjelljen dhe zhvillimin kognitiv të fëmijës, të parandalojë vështirësitë e mëvonshme emocionale dhe të promovojë sjelljen sociale - shpjegon Dr Maria Mehlor, një nga autorët e këtij hulumtimi.

Ekonomistët vlerësojnë se shndërrimi i rritjes ekonomike në mirëqenie për qytetarët, mund të arrihet vetëm me shkallët më të larta të rritje më të madh të prodhimit, investimeve vendore dhe të huaja, si dhe kapaciteteve prodhuese

Koha

Fisnik Pasholli

Shkup, 4 nëntor—Maqedonia në periudhën e kaluar 25 vjeçare në mesatar ka shënuar një rritje ekonomike prej afër 2 për qind në mesatare. Vetëm për vitin 2018, autoritetet vendore dhe ato ndërkombëtare prezantojnë shifra të ndryshme në lidhje me shkallën e rritjes ekonomike në Maqedoni që lëvizin prej 2.8 për qind që parashikohet nga ana e qeverisë, 2.5 për qind nga ana e Bankës Botërore, 2.3 për qind që parashikon Banka Popullore e Maqedonisë apo 1.6 për qind sipas Fondit Monetar ndërkombëtar.

Megjithatë, ekonomistët vlerësojnë se shndërrimi i rritjes ekonomike në mirëqenie për qytetarët, mund të arrihet vetëm me shkallët më të larta të rritjes ekonomike. Me fjalë të tjera, njohësit e çështjeve ekonomike theksojnë se Maqedonia si shtet nevojitet të ketë rritje

KONTRADIKTAT NË MES TË REALITETIT DHE SHIFRAVE

KA RRRITJE EKONOMIKE, POR JO EDHE MIRËQENIE



më të madh të prodhimit, investimeve vendore dhe të huaja, kapaciteteve prodhuese, eksportit cilësor, rritjes së fuqisë punëtore kapitalit, dhe të gjithë faktorëve të tjerë që përbëjnë një ekonomi nëse dëshiron të ketë rritje ekonomike prej së paku 5 për qind në vit. Nga ana tjetër, vlerësohet se shkalla mesatare e rritjes ekonomike, e parashikuar për këtë vit është e pamjaftueshme dhe pa ndikim në mirëqenien e qytetarëve të Maqedonisë.

“Rritja prej 2.8 për qind nuk i zgjidh problemet që mendojnë qytetarëve. Si shtet na nevojiten shkal-

lë të rritjes ekonomik mbi pesë për qind për më shumë vite me radhë që mund të realizohet në ambient stabil ekonomik dhe politik me qëllim që qytetarët të mund të kenë benefit prej kësaj rritjes përmes përmirësimit të standardit të tyre jetësor”, thotë ish guvernatori i Bankës Popullore, Petar Goshev.

Në anën tjetër, në të ardhmen për të pasur një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik, ulje të shkallës së papunësisë dhe rritje të eksportit të produkteve vendore, sfida për ekonominë e Maqedonisë mbetet arritja e shkallëve të larta të rritjes ekonomike prej 5 për qind

për çdo vit në një cikël edhe më të gjatë se katër vite, si mënyrë e vetme për përmirësimin më të shpejtë të standardit të qytetarëve.

Kohë më parë numri një i Odës ekonomike të Maqedonisë, Branko Azeski theksoi se qëllimi afatgjatë i zhvillimit ekonomik duhet të jetë arritja e shkallës vjetore të rritjes prej 4.5 për qind në kushte stabilitetit makroekonomik, apo inflacionit të ulët dhe stabil, qëndrueshmërisë së pozitive fiskale dhe të bilancit pagesor, dhe stabilitetit të tregut financiar dhe atij të punës.

“Në këtë drejtim nevojitet konsolidimi i financave publike, apo

ulja e konsumit publik në rreth 35 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, reforma në sistemin pensional dhe të sigurimit shëndetësor si dhe depolitizim dhe udhëheqje profesionale e ndërmarrjeve publike. Nevojitet të vendoset edhe sistem efektiv për mbrojtjen e borxhlinjve dhe marrëveshjeve si dhe reforma të tregut të punës përmes reformës së arsimit dhe vendosjes së tij në funksion të punëdhënësve”, thotë kryetari i OEM, Branko Azeski.

Sipas tij nevojitet të përgatitet edhe tereni i nevojshëm në aspekt ligjor dhe të infrastrukturës për partneritetin privat-publike duke marrë parasysh efikasitetin dhe produktivitetin e ulët të ndërmarrjeve publike që do të krijojë kushte për investime efikase në sektorin publik. Ndryshe, nga Oda ekonomike e Maqedonisë thonë se për vendin e vetmja mënyrë për rritje më të madhe ekonomike është industrializimi i sërishëm i vendit apo rritja e kapaciteteve të industrisë prodhuese, si dhe rritja e prodhimeve për eksport që kanë vlerë më të lartë të shtuar apo i prodhimeve finale me teknologji të lartë.

Spektori për Punë të Brendshme në Tetovë, kohë më parë në një përgjigje me shkrim për gazetën Koha, kishte theksuar se ata do të vlerësojnë se cila rrugë pas rikahëzimit mund të ndikojë në sigurinë e përgjithshme në komunikacionin rrugor në pajtim me rregullativën ligjore dhe do të mundësojë qarkullim më të lirshëm

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 4 nëntor—Më në fund këshilltarët e komunës së Tetovës kanë miratuar propozim vendim për shpalljen e disa rrugëve në qytetin e Tetovës si rrugë njëkahëshe. Është vendosur që rrugët “Strasho Pinxhur”, “Todor Xhipovski Merxhan”, “Boris Kidriç” tek shkolla e mesme “Bratsvo-Migjeni”, rruga “Kuzman Josifovski Pitu”, të jenë njëkahëshe pasi që në këto rrugë sipas sektorit përkatës, nuk i përm-bushin kriteret që të jenë dykahë-

RIORGANIZIM I TRAFIKUT NË TETOVË

SHTOHEN DISA RRUË NËKAHËSHE



she dhe e stërnarkojnë komunikacionin në Tetovë. “Gjithsej janë 30 rrugë njëkahëshe që janë shpallur. Disa rrugë kanë qenë me propozim të Sektorit të Punëve të Brendshme, kurse ne dhamë edhe disa propozime shtesë, për disa rrugë me qëllim që të kemi një komunikacion më të lirshëm edhe për parkim, edhe për këmbësorët por edhe për automjeteve, ngase ne kemi shumë probleme me parkimin, prandaj menduam që të ketë edhe vend për parkim,

edhe për trotuar por edhe lëvizje më të lirë pa ngarkesa. Propozuam që edhe shtatë rrugë tjera të jenë pjesë e këtij vendimi, ku nuk ka trotuare. Këta rrugë nuk kanë gjërësinë e mjaftueshme pra nuk janë as 6 metra”, tha Elmira Mustafai nga Sektori për Komunikacion në komunën e Tetovës.

Konkretisht bëhet fjalë për rrugët që janë në pjesën nga posta, biblioteka e vjetër dhe për tek Shkolla e Muzikës dhe sipas tij, pritet që efektet e para të jepen pas

vendosjes së sinjalizimit kur edhe do të ketë prani më të shtuar të policisë në atë pjesë që do të vendos rregull më të madh. “Efektet e para pritet të jepen pasi që të vendoset sinjalizimi vertikal dhe vozitësit të respektojnë ato shenja. Mund të ketë një periudhë kur edhe do të jetë test periudha derisa vozitësit të mësohen dhe më pas do të hyjë në fuqi edhe me ndëshkime për ata që nuk do të respektojnë të njëjtat shenja. Nga ana e komunës presin që policia të jetë në detyrë dhe të marrë masa më të rrepta, ngase për këta rrugë vet iniciatore ka qenë policia rrugore që të shpallen njëkahëshe. Ne presim që vet policia të jetë më shumë prezente, sepse ata kanë kërkuar që listës së rrugëve njëkahëshe tu bashkangjiten edhe këta rrugë dhe ne jemi pajtuar dhe jemi dakorduar se me të vërtetë në atë pjesë ka nevojë që rrugët të jenë njëkahëshe”, sqaroi Elmira Mustafai nga Sektori për Komunikacion në komunën e Tetovës. Sipas infor-

macioneve të deritanishme, kjo pikë e rendit të ditës njëherë është hjekur nga rendi i ditës për shkak të konsultimeve shtesë me policinë.

“Me shpalljen e këtyre rrugëve njëkatëshe, dukshëm do të shkarkohet regjimi i zhvillimit të komunikacionit në ato rrugë. Ndryshimet në regjimin e komunikacionit të rrugëve nga nenin 1 i këtij Vendimi si rrugë njëkahëshe do të jenë të karakterit të përkohshëm, deri në realizimin e planeve detale urbanistike në ato rrugë” thuhet në propozim vendim të miratuar në seancën e fundit të këshillit të komunës së Tetovës. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, kohë më parë në një përgjigje me shkrim për gazetën Koha, kishte theksuar se ata do të vlerësojnë se cila rrugë pas rikahëzimit mund të ndikojë në sigurinë e përgjithshme në komunikacionin rrugor në pajtim me rregullativën ligjore dhe do të mundësojë qarkullim më të lirshëm.

Artan Shyti, kryetar i Shoqërive Shqiptare të Basteve, shprehet se kompanitë do të kërkojnë 30-45 milionë euro dëmshpërbim në gjykatë

BIZNESI I KUMARIT NË SHQIPËRI

NDALIMI MUND T'I KUSHTOJË QEVERISË 45 MILIONË EURO



LOJËRAT E FATIT NË EUROPE

Europa nuk ka në vetvete një model të unifikuar lidhur me sektorin e kumarit. Bashkimi Europian, edhe pse ka një legjislacion përfshirës për shumë aspekte, këtë pjesë e ka lënë të rregulluar pjesërisht në rregulloret e veta, duke lënë shtetet të vendosin në mënyrë autonome sesi do t'i menaxhojnë lojërat e fatit. Por sot askush nuk ka një model perfekt të funksionimit të këtij tregu. Të dhënat tregojnë se pavarësisht ndryshimeve të shpeshta ligjore, aplikimit të filtrave dhe kufizimeve, sërish modelet sfidohen në detyrat gjykatash apo në terren, duke detyruar sërish

vendet të kërkojnë shpëtim në tjetër strehë. Me lulëzimin e lojërave elektronike në distancë apo në internet, fokusi i autoriteteve në shtetet europiane është zhvendosur në këtë pjesë duke tentuar të legalizojnë atë pjesë të rregullt, të ndalojnë faqet abuzuese apo të arrijnë marrëveshje me kompanitë që kanë faqet online që të vendosin kufizime si për shembull: nëse arrihet një sasi shpenzimi, llogaria e personit që luan të bllokohet automatikisht apo për personat që duan të mos tundohen për të luajtur të regjistruhen në listën e atyre që e kanë të ndaluar të hyjnë dhe të luajnë.

ruese do të jenë të pakta në numër. Ajo që mbetet ende e paqartë është pjesa e Sistemit të Monitorimit Online të Lojërave të Fatit.

Por ligji për lojërat e fatit, me ndryshimet e fundit, nuk i bllokoi gjithë lojërat e fatit. Disa prej tyre do të vijojnë të funksionojnë. Nga 1 janari 2019, askush nuk mund të vendosë baste sportive në pikë fizike dhe online në kompani shqiptare, askush nuk mund të luajë në makina slot në kazino elektronike, nuk ka më baste për gara me kuaj. Aktualisht të vetmet lojëra që parashikon ligji janë bingo televizive, bingo tradicionale dhe lojërat e Lotarisë Kombëtare. Kjo e fundit është një koncesion 10-vjeçar që, sipas ligjit në fuqi, ka në treg disa lloje lojërash, por asnjëra prej tyre nuk përfshin element të VLT. Po kështu, kazinotë do të funksionojnë vetëm në hotelet me 5 yje, pra resort-kazino.

Biznesi i kumarit ka qenë gjithmonë një ndër lobet më të fuqishëm në vend. Jo rastësisht dy vite më parë ia dolën që të shtynin ligjin, duke marrë më shumë kohë para ndalimit. Por duket se në çdo marrëdhënie ka një krisje dhe këtë herë u kurorëzua me "divorc". Një vendim që duhet të ndalonte vetëm kazinotë elektronike u kthye në ortek, që mori me vete bastet sportive dhe lojërat elektronike në distancë. Në aspektin social, qeveria ka fituar pikët e saj, në aspektin e trajtimit të një biznesi kontribuues në buxhet nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Kompanitë e basteve sportive pranojnë se ky biznes kishte dalë jashtë kontrollit, por sipas tyre, bashkëfajtores është qeveria, e cila ka miratuar kaosin ku "notonte" sektori. Ashtu siç pritej, divorci do të bëhet në Gjykatë dhe kompanitë pretendojnë rreth 45 milionë euro dëmshpërbim.

Deri në momentin e fundit kur ndryshimet ligjore ishin ende një draft, përfaqësues të basteve sportive shprehën gatishmërinë për të negociuar me qeverinë, duke kërkuar një zgjidhje alternative. Me kthimin e këtij drafti në ligj, kompanive u ka mbetur si rrugë gjykata. Artan Shyti, kryetar i Shoqërive Shqiptare të Basteve, shprehet se kompanitë do të kërkojnë 30-45 milionë euro dëmshpërbim në gjykatë. "Vlera e llogaritit e dëmshpërblimit që do të kërkojmë nga qeveria shqiptare është 30-32 deri në 40-45 milionë euro. Kemi këtë lloj luhatshmërie pasi ende mbeten gjëra që janë të paqarta. Dëmi ka filluar që në këtë moment, pasi kemi probleme për të arkëtuar xhiron në pika. Janë detyrime të ndryshme. Kemi disa elemente që janë shumë komplekse, si qiratë e dhëna apo ato të parapaguara, pretendime nga qi-

radhëniet që duan të marrin në varësi të kontratës. Punonjësit mund të kenë pretendimet e tyre dhe nëse zbatojmë pikë më pikë Kodin e Punës për çdo punonjës, vetëm kostoja e pagave na shkon 10 milionë euro. Ata nuk mund t'ia kërkojnë shtetit. Do të na i kërkojnë ne. Ne pastaj do t'ia kërkojmë shtetit se ndërhyri në

ligj, pa menduar për pasojat tona. Tek e fundit, ne kemi një licencë që është pronë që na i ka dhënë po shteti dhe na mbaron në 2026", - shprehet Shyti.

Kjo do të thotë që mbyllja e gjithë basteve sportive dhe lojërave të fatit është kapitull me fund të palumtur për privatët që kishin deri më sot licencat, ndërkohë që

nga nesër është shteti ai që do t'i organizojë. Praktikisht monopoli i kalon qeverisë. Në përputhje me situatën e re në treg është miratuar një vendim që pezullon ristrukturimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Vepriprimaria e këtij të fundit pritet të nisë në janar 2018 me regjimin e ri dhe subjektet e vetme ope-

BULLGARI, EKONOMIA MË KONKURRUESE NË BALLKAN

Bullgaria mban vendin e 51-të në renditjen e Forumit Ekonomik Botëror për 2018. Sipas indeksit, Bullgaria është ekonomia më konkurruese në Ballkan, përpara Rumanisë (në vendin e 52), Greqisë (57), Turqisë (61), Serbisë (65), Malit të Zi (71), Shqipërisë (76) dhe Bosnjë- Hercegovinës (91), raporton Money.bg

Sipas kriterëve individuale, Bullgaria renditet si një ndër vendet më të mira për adoptimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në biznes (në ven-

din e 30) dhe në kapacitetin e inovacionit (48). Rënditjen më të ulët, ajo e ka në drejtim të institucioneve (në vendin e 70) dhe sistemit financiar (në vendin e 71).

Në renditjen e këtij viti, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë ato që kryesojnë si ekonomia më konkurruese në botë për herën të parë që prej vitit 2008. 10 shtetet e para në këtë renditje pas Amerikës, janë: Singapori, Gjermania, Zvicra, Japonia, Holanda, Hong-Kongu, Mbretëria e Bashkuar, Suedia dhe Danimarka. Rezultatet e të gjitha

këtyre shteteve kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2017.

Forumi Ekonomik Botëror tregon se rimëkëmbja ekonomike është duke ecur me ritëm të mirë, duke parashikuar një rritje prej 4% në 2018 dhe 2019, por ende vazhdojnë të mbeten të pranishme një numër i madh rreziqesh. Një nga këto është edhe lufta tregtare midis SHBA-së dhe Kinës. Në këtë renditje bëjnë pjesë 140 vende me 98 indikatorë që masin investimet e biznesit dhe produktivitetin.



EVN

Në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të EVN Maqedoni SHA- Shkup për shitje të pronës së patundshme nr. 02-1294/2/2 të datës 24.10.2018, shpallim:

THIRRJE PUBLIKE nr. 3-1/2018**Për shitje të pronës së patundshme**

Pronë e patundshme (objekt afarist) në Kërçovë, e cila përbëhet prej:

1. Objektiv A2-2 (banesë –banimi-afariste) në FP 18342 në KK Kërçovë 6 në PK 2216/5:

→ banesa 1, kati PR, hyrja 1, nr. 1, OA me sipërfaqe të përgjithshme prej 58 m²

Të drejtë të blerjes kanë të gjithë personat e interesuar fizik dhe afaristë

1. Çdo ofertues mund të parashtrojë vetëm një ofertë.
2. Mjetet themelore – pronë e patundshme, lëndë e kësaj thirrjeje, shiten sipas principit “E parë e blerë” pa të drejtë në ankesë.
3. Për mjetet themelore – pronë e patundshme, lëndë e kësaj thirrjeje, mund të realizohet kqyrje nëpërmjet personit Ilija Kirovski dhe të njëjtat të shihen me ndërmjetësim të EQK Kërçovë çdo ditë pune prej orës 10:00 deri në orën 14:00.
Qasja në dokumentacion për pronën e patundshme që është lëndë e kësaj thirrjeje mund të realizohet tek personi Ilija Kirovski në drejtorinë e EVN Maqedoni SHA Shkup, rr. “11 Tetori” nr.9, në periudhë prej 5.11.2018 deri më 12.11.2018, çdo ditë pune prej orës 10:00 deri në orën 14:00.
4. Ofertat të dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim: “MOS E HAP”, OFERTA SIPAS THIRRJES PUBLIKE 3-1/2018 PËR SHITJE TË PRONËS SË PATUNDSHME (me shënim të numrit rendor dhe titullit të pronës së patundshme për të cilat dedikohen ofertat) deri më 12.11.2018, deri në orën 14:00.
5. Ofertat e dhëna nga personat fizikë duhet të përmbajnë: Çmim të ofruar në MKD pa TVSH; PAGESË TË DEPOZITIT prej 30.000,00 MKD për objektin për të cilin dorëzohet ofertë me dëshmi kopje nga ekzemplari nga pagesa e realizuar, emër dhe mbiemër të ofertuesit; numri i letërnjoftimit, adresa e banimit, e-adresa dhe telefoni për kontakt.
6. Ofertat e dhëna nga personat juridikë duhet të përmbajnë: Çmimin e ofruar në MKD pa TVSH; pagesë të depozitit prej 30.000.00 MKD për objektin për të cilin dorëzohet ofertë me dëshmi – kopje të ekzemplarit të pagesës së realizuar, emri i personit juridik dhe adresa (sipas regjistrimit); numri tatimor; xhiro-llogaria në vlerë të denarit dhe banka – deponues; emri i nënshkruesit të autorizuar dhe telefoni për kontakt, faksi dhe e-adresa.
7. Depoziti të paguhet në EVN Maqedoni SHA Shkup, xhiro-llogaria 210059337735190, Numri tatimor MK 4030005565759, Deponues NLB Tutunska Banka SHA Shkup. Ofertat duhet të jenë të shkruara me kompjuter/makinë shtypi dhe të nënshkuara personalisht.

8. Ofertat dorëzohen personalisht në arkivin e “EVN Maqedoni SHA Shkup” – Shkup, rruga “11 Tetori” nr. 9, 1000 – Shkup ose nëpërmjet postës me afat të kufizuar. Ofertat duhet të arrijnë dhe të pranohen / të regjistruara në arkivin e “EVN Maqedoni SHA Shkup” – Shkup, rruga “11 Tetori” nr. 9, 1000 – Shkup më së voni deri më 12.11.2018, deri në ora 14:00. Ofertat të cilat do të arrijnë në arkivin e EVN Maqedoni pas afatit të shënuar nuk do të merren në shqyrtim.
9. Shitësi do të bëjë hapjen e ofertave të arritura gjatë së cilës mban të drejtën të realizojë procedurë negociatash lidhur me ofertat pas dorëzimit të ofertave.
10. Shitësi ka të drejtë të aktivizojë depozitin, gjegjësisht të mos e kthejë depozitin e Ofertuesit më të volitshëm nëse Ofertuesi më i volitshëm (blerësi) nuk kryen pagesën e mjetëve në afat prej 14 (katërbëdhjetë) ditë pune nga data e konfirmimit për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm ose blerësi tërheq ose ndryshon ofertën pas afatit përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
11. Depoziti i ofertuesve tjerë do të kthehet nga ana e EVN Maqedoni në afat prej katërbëdhjetë (14) ditë nga dita e hapjes së ofertave, gjegjësisht nga dita e procedurës së realizuar për negociatën, nëse shitësi realizon të drejtën që të realizojë procedurë për negociatën.
12. Afati për pagesë të mjetëve të përgjithshme financiare nga oferta është 14 (katërbëdhjetë) ditë pune nga dita e konfirmimit të zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm (Blerësit).
13. Shitja do të realizohet në pajtim me rregullat ligjore pozitive, të zbatueshme në pajtim me natyrën e objektit afarist, lëndë e shitjes.
14. Shpenzimet të cilat do të burojnë nga shitblerja e pronës së patundshme (TVSH dhe tatimi i shitblerjes së pronës së patundshme) bien në barrë të Blerësit, gjithashtu edhe shpenzimet për verifikim të noterit janë në barrë të Blerësit.
15. Nëse ofertuesi më i mirë i zgjedhur nuk e paguan avansin në afatin e dhënë, pas kalimit të këtij afati logaritet se nuk është i përzgjedhur për ofertuesin më të volitshëm.
16. Shitësi nuk është i obliguar ta pranojë cilindo ofertë, gjegjësisht mban të drejtën të mos zgjedhë ofertuesin më të volitshëm për pronën e patundshme që është lëndë e kësaj thirrjeje publike.
17. Informacionet shtesë për shpalljen mund të merren prej orës 10:00 deri në orën 14:00, çdo ditë pune prej 5.11.2018 deri më 12.11.2018 tek personi:
→ për informacione për objektet dhe mundësinë e kqyrjes së objekteve
ilija.kirovski@evn.mk, Ilija Kirovski tel. 02 205 000 lokali 43457 dhe 072 933 457.
→ për çështje komerciale radoslav.jauleski@evn.mk, Radoslav Jauleski tel. 02 3 205-000 lokali 43129 dhe 072 933 129.

EVN Maqedoni SHA Shkup

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Embassy to the Republic of Macedonia

Ambasada e Republikës të Kosovës në Republikën e Maqedonisë –Shkup, shpall:

KONKURS

Për vend të lirë pune:

Pozita : Personel shërbyes

Vendi punës: Ambasada e Republikës së Kosovës në Shkup

Afati i aplikimit: 8 ditë kalendrike nga dita e shpalljes, **05 deri me 12 Nëntor 2018**

Pozita /Personel shërbyes në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup me orar të rregullt.

Kriteret dhe kushtet e nevojshme

- a) Kandidati duhet të ketë të kryer shkollën e mesme përkatëse ose ekuivalente
- b) Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas ose banor i përhershëm i shtetit pranues (Maqedoni) apo shtetas i ndonjë vendi të tretë
- c) Duhet të jetë i/e gatshëm/e dhe motivuar të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e ndërlidhura me pozitën e kërkuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- a) Kandidati/ja duhet të ofroj shërbimet sipas Konkursit në Ambasadën e Republikës të Kosovës në Shkup, për të gjithë hapësirën/fushat, të përcaktuara në kontratën e punës.
- b) Orari i punës: nga e hëna deri të premten, 09-17h

Dokumentet e kërkuara:

CV e shkurtë dhe kopje e letër njoftimit.

Dokumentet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 10h deri në 16h.

Adresa: Samoilova 136, Shkup.

Në bazë të nenit 20-g paragrafi 1 nga Ligji për punonjësit në administratën shtetërore (Gazeta publike e RM nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), neni 22 paragrafi 1 p. 1 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016, 120/2018 dhe neni 34 nga Ligji për standarde të nxënësve nr. 52/05, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014 dhe 146/2015, në pajtim nga Ministria e financave nr. 09-3082/3 nga data 20.06.2018 dhe vendimi për publikim të shpalljes publike nr. 02-242/1 nga data 19.10.2018, drejtori i IPSHNQSH “Zdravko Cvetkovski” Shkup, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 1/2018

1. Për punësimin e 3 (tre) personave për kohë të pacaktuar në vendin e punës- edukator- 3 (tre) realizues me shifrën OBN 03 02 I03 001
2. Për punësimin e 2 (dy) personave për kohë të pacaktuar në vendin e punës - mirëmbajtës të higjienës- 2 (dy) realizues me shifrën OBN 04 01 A01 002
3. Për punësimin e 1 (një) personi për kohë të pacaktuar në vendin e punës- enëlarës - 1 (një) zbatues me shifrën OBN 04 04 A01 007

Kandidatët që do të paraqiten për vendin e punës nën pikën 1 nga kjo shpallje publike, përveç fletëparaqitjes duhet të parashtrojnë edhe dëshmi për plotësimin kushteve të punës në vijim edhe atë:

- **Kushte të përgjithshme** - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; të përdorë gjuhën maqedone në mënyre aktive; të jetë i moshës së rritur; Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - **Kushtet e veçanta** - kualifikime profesionale të duhura- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 dhe përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike.
- Orari i punës është me ndërime, 40 orë në javë, me rrogën neto fillestare 23.958,00 denarë.

Kandidatët që do të paraqiten për vendin e punës nën pikën 2 nga kjo shpallje publike, përveç fletëparaqitjes duhet të parashtrojnë edhe dëshmi për plotësimin kushteve të punës në vijim edhe atë:

- **Kushte të përgjithshme** - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; të përdorë gjuhën maqedone në mënyre aktive; të jetë i moshës së rritur; Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - **Kushtet e veçanta** - kualifikime profesionale të duhura- arsim fillor/i mesëm
- Orari javor i punës është nga e hëna deri të premten nga ora 06:00 deri 13:00 (ndërrimi i parë) dhe nga ora 13:00 deri 20:00 (ndërrimi i dytë) dhe çdo të shtune nga ora 06:00 deri 11:00; me rrogë neto fillestare prej 13.117,00 denarë.

Kandidatët që do të paraqiten për vendin e punës nën pikën 3 nga kjo shpallje publike, përveç fletëparaqitjes duhet të parashtrojnë edhe dëshmi për plotësimin kushteve të punës në vijim edhe atë:

- **Kushte të përgjithshme** - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; të përdorë gjuhën maqedone në mënyre aktive; të jetë i moshës së rritur; Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - **Kushtet e veçanta** - kualifikime profesionale të duhura- arsim fillor/i mesëm
- Orari javor i punës është nga e hëna deri të premten nga ora 06:00 deri 13:00 (ndërrimi i parë) dhe nga ora 13:00 deri 20:00 (ndërrimi i dytë) dhe çdo të shtune (ose të diele) nga ora 06:00 deri 11:00; me rrogë neto fillestare prej 13.469,00 denarë.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet më së voni në afat prej 15 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike, përmes kontrollit të dokumenteve të parashtuara, dëshmimeve për plotësimin e kushteve për vendin e punës dhe intervista e realizuar me kandidatët e paraqitur.

Fletëparaqitja duhet të përmbajë: të dhëna për kandidatin, letër e shkurt motivimi (për kandidatët për vendin e punës nën pikën 1 nga kjo shpallje publike) dhe biografi të shkurtër.

Afati për paraqitje zgjat tre ditë nga dita e publikimit.

Si dita e parë e publikimit konsiderohet dita e fundit e publikimit në mediat publike.

Dokumentacioni jo i plotë, jo i rregulluar dhe i dorëzuar me vonësë nuk do të bëhet lëndë për shqyrtim nga ana e komisionit për zgjedhje të kandidatëve.

Fletëparaqitja dhe dokumentet të parashtrohen në formë letrë në arkivin e IPSHNQSH “Zdravko Cvetkovski” Shkup në rrugën Drezdenska nr. 1 Shkup.

Informata shtesë në tel: 02-3064-236

IPSHNQSH “Zdravko Cvetkovski” Shkup

TRAGJEDI NË PALERMO, MBYTEN 9 ANËTARË TË NJË FAMILJE BRENDIA VILËS

Nëntë persona nga një familje, duke përfshirë gra dhe fëmijë kanë vdekur pas përmbajtjes së një vile në lagjen Cavallaro a Casteldaccia të Palermos për shkak të përmbajtjeve dhe daljes nga shtrati të lumit Milicia.

Kjo është tragjedia më e rëndë e ndodhur në Itali gjatë kësaj jave ku moti i keq ka përfshirë vendin nga veriu në jug, duke shkaktuar viktima e të plagosur prej erërave të forta dhe reshjeve të dendura të shiut.

Vila që u përmbyt ndodhet në kufirin e komunave Altavilla Milicia dhe Casteldaccia, jo shumë larg autostradës Palermo-Catania.

Në shtëpi kishte miq dhe të afërm që kalonin mbrëmjen së bashku. Dy njerëz, një burrë dhe një vajzë, arritën të shpëtonin sepse dolën për të blerë ëmbëlsira. Një person i tretë jashtë shtëpisë dha alarmin me telefonin e tij celular duke u mbajtur pas një peme kur



shtëpia u zhyt në ujë.

Sipas policisë italiane viktimat janë mbytur sepse uji mbërriti shpejt duke prekur për pak minuta lartësinë e tavanit të shtëpisë.

Emrat e viktimave: -Pak Rachel Giordano, 1 vjeç; -Francesco Rugho, 3 vjeç; -Federico Giordano, 15 vjeç; E ëma Stefania Catanzaro, 32 vjeçe dhe bashkëshortja e njërit prej të mbijetuarve Giuseppe Giordano, i cili është në spital me një fë-

mijë (ndoshta me vajzën e saj); Gjyshi Antonino Giordano, 65 vjeç dhe gruaja e tij Matilde Comito, 57 vjeç; Djali i tij Marco Giordano, 32 vjeç dhe motra e tij Monia Giordano, 40 vjeç; Nunzia Flaminia, 65 vjeç. "Një tragjedi e tmerrshme", tha kryetari i komunës së Casteldaccia, Giovanni Di Giacinto, i cili arriti në vendin e tragjedisë.

"Ne nuk mund të kuptojmë se si ndodhi. Lumi kurrë nuk ka

shkaktuar diçka të tillë, nuk është mbushur kurrë plot këtu në Casteldaccia", shtoi ai.

Ndërkohë viktima e dhjetë u shënuar dje në Vicari, ku një njeri u rrëmbye së bashku me makinën e tij nga përroi i San Leonardos.

Viktima ishte munduar të shpëtonte një të ri të mbërthyer në stacionin e gazit, ndërkohë që dy persona janë zhdukur në të njëjtën zonë. /Gazeta Shqip



Aksidenti në rrugën Zhelinë-Grupçin, 7 persona të lënduar

Të shtunën rreth orës 17 e 30 ndodhi një aksident në rrugën Zhelinë-Grupçin ku janë lënduar shtatë persona. Katër persona kanë qenë në veturën e tipit Audi si dhe 3 persona në veturën Fiat sipas informatave të para personat që kanë qenë në Fiat janë më të lënduarit nga ky aksident.

Ekipi i zjarrfikësve kanë dalë menjëherë në vendngjarje dhe u kanë ofruar ndihmën e parë njëtoji për Televizionin Koha, komandanti i njësisë teritoriale kundër zjarrit në Tetovë Uka Aliti. Në vendin e ngjarjes kanë arritur pjestarë të policisë nga sektori për punë të brendshme në Tetovë të cilët kanë kryer hetimet e nevojshme për të vërtetuar shkaqet që shkaktuan këtë aksident.

Sherr me grushte për një vend parkimi, arrestohet aktori i njohur



Aktori amerikan Alec Baldwin është arrestuar në Nju Jork, nën akuzën se ka rrahur me grushte një person, pas një debati për një vend parkimi. Një zëdhënës i policisë lokale deklaroi se aktori u ndalua dhe iu komunikua akuzat e agresionit. Kjo nuk është hera e parë që 60-vjeçari përballlet me ligjin. Në vitin 2014, ai u arrestua për prishje të rendit publik. Sipas policisë, një anëtar i familjes së tij kishte zënë një vend parkimi për Kadillakun e Baldwin, kur papritur një person tjetër ndërhyri me automjetin e vetë dhe e zuri hapësirën. Mes aktorit dhe personit tjetër nisi një sherr verbal që kaloi në shtyrje fizike dhe më pas në goditjen me grusht. Personi i lënduar, 49-vjeç, u dërgua në spital pas dhimbjeve në nofull.

Masakrohet me thikë "babai i talebanëve"

Vritet me thikë në Pakistan, kleriku i njohur fetar, Maulana Samiul Haq, i cilësuar edhe si "babai i talibanëve".

Mediat lokale duke cituar djalin e klerikut, Hamidul Haq, thanë se ai u qëllua me thikë nga një person ende i paidentifikuar në shtëpinë e tij më 2 nëntor.

Djali i klerikut të njohur tha se e ka gjetur babain e tij në shtrat të mbuluar nga një lum gjaku.

Por nga ana tjetër lajmet janë kontradiktore disi pasi familjare të tjerë të klerikut thanë për agjencinë reuters se Maulana Samiul Haq ishte qëlluar me arme nga persona te panjohur.

Megjithatë, agjencia e lajme-



ve, Reuters ka cituar disa familjarë të klerikut që kanë thënë se ai është qëlluar me armë zjarri nga disa sulmues të panjohur.

Samiul Haq, 80 vjeç ka drejtuar

një shkollë islamike në Provincën Khyber Pakhtunkhwa në Pakistan. Ai ka qenë i lidhur me Partinë, Tehreek-i-Insaf në zgjedhjet e 25 korrikut.

I riu shqiptar godet në kokë policët grek



31 - vjeçari shqiptar, emri i të cili nuk bëhet i ditur u ndalua nga policia për kontroll teksa ky i fundit e ka refuzuar kërkesën e tyre duke

i kundërshtuar dhe goditur forcat e rendit.

Sipas portalit të lajmeve News të Greqisë, shtetasi shqiptar në

momentin e ndalimit ka qenë nën efektin e alkoolit.

Dy policët grek të moshës 45 dhe 47 vjeç kanë pësuar lëndime fizike. Njëri prej tyre pësoi dëmtime në vesh ndërsa tjetri në dorë. U është dashur të thërrasin patrulla të tjera për të bërë të mundur arrestimin e shqiptarit.

Edhe pse të shumtë në numër, forcat e rendit e kanë patur të vështirë shoqërimin e tij drejt qelisë së paraburgimit pasi 31 - vjeçari ka vijuar të tregojë rezistencë dhe kundërshtim.

Ndaj tij rëndon akuzat e kundërshtimit, fyerjes, kërcënimit dhe shkaktimit të lëndimeve trupore.



Hyn për të grabitur, por zihet nga pronari

Tenton të vjedhë një banesë, por hajduti i "pa fat" pikaset nga pronari dhe largohet pasi e godet me një shkop. Ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të datës 2 tetor 2018, ku shtetasi Syl Ç, kishte shkuar gjatë natës për të vjedhur banesën e bashkëfshatarit të tij, shtetasit A.P. Hajduti ka bërë zhurmë në momentet që hyri në banesë dhe pronari është ngritur nga krevati dhe bëri një kontroll rreth qark. Ndërkohë, Syl Ç., ndodhej brenda dhe prej frikës e ka goditur bashkëfshatarin e tij me një shkop, duke i shkaktuar dëmtime të lehta. Më pas është larguar me shpejtësi prej frikës.

Menjëherë pas ngjarjes, shtetasi A.P., ka njoftuar policinë. Gjatë denoncimit, ai ka bërë një përshkrim të personit që e goditi dhe në bazë të provave, policia bëri të mundur identifikimin dhe arrestimin e autorit në fjalë. Materialet për veprime të mëtejshme i kaluan Prokurorisë Tropojë, për veprën penale "Vjedhja me dhunë, mbetur në tentativë". /Shqip

NGA DITARI I GAZETARIT

Faleminderit Kosovë!



Nga
Rexhep Torte

Kosova është pjesë e rëndësishme e jetës sime. Lidhjet e mia me Kosovën ekzistojnë qysh si nxënës i tetëvjeçares kur lexoja "Zërin e Rinis", e më vonë edhe "Rilindjen" dhe "Jeta e re". Në vazhdimësi lexoja shumë, shkruaja dhe recitoja bukur. Gjatë studimeve në Beograd u bëra anëtar i Shoqatës Letrare Studentore "Përpjekja" dhe në vitin 1967 me zgjedhjen kryetar të kësaj shoqate, e cila me nismën time u bë shoqatë letrare-muzikore sepse kishte një numër të madh të studentëve shqiptarë që studjonin Akademine dhe Muzikën në Beograd si edhe studentë këngëtaë të talentuar. Asokohe pata rastin të njihem me shumë shokë dhe me ajkën letrare e kulturore të Kosovës, në mbrëmjet e shkëlqyera letrare që i organizonim në ambientet e Fakultetit Filologjik në Beograd. Gjatë punës sime si përkthyes në gjuhën shqipe për institucione të ndryshme, në vitin 1971 me kërkesë të Rexhep Zogaj, drejtor i NGB "Rilindja" u punësua gazetar i rregullt i "Rilindjes" në Dibrë. Por ky gëzim nuk zgjati shumë.

KUSH DHE PSE MA NDALËN HOVIN?!

Nijazi Limanoski, deputet Republikan, drejtor i Radio Dibrës dhe korrespondent i të gjitha gazetave shqipe, dhe Halit Basha, zëvendës drejtor i Radio Dibrës, sekretar në Pallatin e Kulturës-Dibrë dhe korrespondent honorar i "Rilindjes" dhe "Flaka e Vëllezërimit", (në faqen e parë të Dosjes së policisë që mu mundësua ta marr në janar të vitit 2001, figurojnë emrat e kodoshëve Nijazi Limanoski dhe Halit Basha) për arsye miskine të konkurrencës gazetareske dhanë deklarata të rreme në Policinë e Dibrës dhe në Komitetin e LKJ-së, për çka Aktivi Politik i Dibrës vendosi që unë të mos jem gazetar i "Rilindjes" nga Dibra, e lidhur me këtë qëndrim i dërgoi edhe letër redaksisë në Prishtinë që unë të mos jem gazetar i "Rilindjes" nga Dibra, letër e cila u botua në këtë gazetë dhe poshtë saj edhe fjalia, "Mbi këtë bazë edhe Redaksia e "Rilindjes" heqën dorë nga gazetari Rexhep Torte". Pas kësaj u përdoqa, u burgosa dhe u përjashtova nga puna. Kjo odisejadë zgjati shtatë vite, ndërsa Nijazi Limanoski nga sistemi i atëhershëm monist për këtë intrigë ndaj meje u shpërblye me titullin e doktoranturës në Shkup, kurse Halit Basha u shpërblye duke e vënë edhe

në krye të Komitetit të LKJ-së- Dibrë dhe u rivendos të vazhdojë punën si korrespondent honorar i "Rilindjes" nga Dibra. Më datë 12.12. të vitit 1972, një muaj e gjysëm pasi fillova të kryej shërbimin ushtarak në Çernomelj të Sllovenisë për të më diskredituar edhe më shumë erdhi thirrja për procesin gjyqësor të caktuar në Dibrë. Në bangën e zezë u ula me uniforme ushtarake. Kryetar i trupit gjyqësor ishte gjykatësi Shehat Marku, ndërsa porota përbëhej nga Hasan Mati dhe Xheladin Pjeça. Procesi gjyqësor ishte i hapur dhe salla e gjyqimit e korridorit ishin mbushur përplot me qytetarë kureshtarë. Ky proces gjyqësor zgjati më shumë se pesë orë, në të cilin kundër meje hapur në ballafaqim dolën dëshmitarë Nijazi Limanoski e Halit Basha duke konfirmuar deklaratat e tyre të dhëna në polici dhe në komitetin e LKJ-së, se "unë para tyre paskështa mbështetur demonstratat studentore që u mbajtën në vitin 1971 në Zagreb, paskështa kritikuar vendimet e KQ të LKJ-së të Kroacisë dhe fjalimin e Titos lidhur me këto demonstrata studentore si edhe shumë të paqëna tjera. Unë kategorikisht i hodha poshtë këto deklarata të këtyre dëshmitarëve zemërligë.

Gjykatësi Shehat Marku, kryetar në procesin gjyqësor përkundër këtyre dëshmitarëve, thirrjes dhe kërcënimeve në disa biseda informative në polici nga përfaqësit e shërbimit të sigurimit shtetëror dhe presionit të jashtëzakonshëm të institucioneve shtetërore të atëhershme, qëndroi i palëkundur dhe me aktvendimin e tij në këtë proces gjyqësor më liroi nga aktakuza duke më shpallur të pafajshëm. Pasi përfundoi procesi gjyqësor unë të nesërmen heret në mëngjez u nisa për kë kazermën ushtarake ku duhej të arrija në kohë. Aktvendimi gjyqësor më erdhi pas dhjetë ditëve të kazermës ushtarake. Ndaj këtij aktvendimi gjyqësor u ankua prokurori, ankesë e cila u pranua dhe u vendos që procesi gjyqësor ndaj meje të përsëritet dhe lëndën time gjyqësore tashmë e mori për të prodhuar Vojislav Zhivkoviç, kryetar i Gjyqit në Dibrë, me të vetmin qëllim e direktivë që domosdo të më dënojë. Në ndërkohë e kreu shërbimin ushtarak dhe i gjendur para një situatë ku më priste dënimi me burg, vendosa që ti shmangen dënimit dhe kalova në ilegalitet që zgjati plot shtatë muaj, gjersa sipas dispozitave ligjore skadoi afati i lëndës gjyqësore. Megjithatë ditën

Pjesa më e madhe e punës sime i është kushtuar Kosovës. Hapat e parë në gazetari i bëra në gazetën "Rilindja" të Prishtinës në nëntor të vitit 1967 kur në Dibrë ndodhi tërmeti shkatërrues me ç'rast informojo rregullisht për gjendjen pas tërmetit



që dola në qytet sërish më arrestuan dhe më dërguan në burgun e Shutkës. U lirova nga burgun pas një jave mbi bazën e ankesës së avokatit tim se kjo lëndë gjyqësore tashmë ishte vjetërruar.

PUNA NË BEOGRAD

Në vitin 1978 u paraqita në konkursin e shpallur për përkthyes në Këshillin Ekzekutiv Federativ të ish Jugosllavisë dhe pas dhënies me sukses të provimit pranues u punësua si përkthyes në gjuhën shqipe në Shërbimin e Përkthimeve në këtë institucion. Pas tre muajve pune për mua kishte arritur mendimi negativ nga Shërbimi i sigurimit shtetëror nga Maqedonia për të cilin më informoi Marin Branko, drejtor i Shërbimit të Përkthimeve dhe ma dha që ta lexoj edhe vetë këtë shkresë. Në fund të kësaj shkrese zyrtare thuhej se, "Rexhep Torte assesi nuk guxon të punojë në organet dhe drejtoritë e administratës federative". Ishte z. Fadil Hoxha, funksionar i lartë i Kosovës, i cili ma vuri dorën dhe unë vazhdova të punoj si përkthyes për Kosovën në këtë shërbim gjer në shpërbërjen të këtij shërbimi. Zotin Fadil Hoxha e njoftova kur isha krye-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 4 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

tar i Shoqatës Letrare-Muzikore "Përpjekja", i cili asokohe na inkurajonte dhe ndihmonte finansiarisht, sidomos në kompletimin e orkestrit me instrumente muzikore e veshje kombëtare, në kremtimin e 10-vjetorit të themelimit të shoqatës, si edhe në shënimin e 500-vjetorit të lindjes së Skenderbeut. Te z. Fadil Hoxha gjithmonë gjeja përkrahje për aktivitetet e shoqatës, për organizimin e mbrëmjeve letrare dhe të koncerteve në mesin e studentëve shqiptarë në Beograd, Zagreb, Lubjanë, Sarajevë, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Shkup dhe Dibër. Zoti Fadil Hoxha pahezitim vinte edhe në pikniqet që ne studentët shqiptarë i organizonim në Parkun Koshutnjak të Beogradit. Gjatë kësaj periudhe unë vendosa kontakte edhe me Shoqatën Kulturore-Artistike "Ramiz Sadiku" të studentëve në Prishtinë. Kjo shoqatë kishte përgatitur dramën për Skënderbeun "Trimi i mirë me shokë shumë" të autorit Sulejman Pitarka me regji të Krist Berishës. Me Ali Gojanin, kryetarin e SHKA "Ramiz Sadiku" organizuam që kjo dramë të shfaqet edhe në Shkup, Dibër dhe Strugë. Me Shoqatën Letrare-Muzikore "Përpjekja" e vizituam edhe Dibrën, Me këtë rast të gjithë anëtarët u vendosën të flejnin në familjet dibrane me të vetmin qëllim për ta zgjeruar miqësinë me familjet dibrane. Kjo gjë doli shumë e efektshme dhe lidhjet shoqërore e familjare që u krijuan vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Në këtë kohë mora nismën dhe e riaktivizova edhe SHKA "Liman Kaba" të Dibrës, e cila i kishte ndërprerë aktivitetet një kohë të gjatë dhe ndihmova edhe në organizimin e koncerteve të saj në Kosovë dhe Beograd. Në këtë drejtim edhe SHKA "Hajdar Dushi" nga Gjakova nën udhëheqjen e fizharmonikistit Zekeria Çarkaxhiu shfaqti koncerte edhe në Dibër.

Nuk kishte gjë më të lumtur kur në vitin 1967 Shoqata Letrare-Muzikore "Përpjekja" mbante orë letrare e shfaqte koncertet e saj në Beograd, Zagreb, Sarajevë e Lubjanë e Prishtinë, i tubonte studentët shqiptarë të këtyre qendrave edhe në Beograd, pastaj mbante mbrëmje letrare e shfaqte koncerte edhe nëpër qytetet e Kosovës e të Maqedonisë. Në këtë drejtim edhe SHKA "Liman Kaba" e Dibrës shfaqte koncertet e saj nëpër qytetet e Kosovës dhe para shqiptarëve që studjonin apo jetonin e punonin në Beograd. SHKA "Hajdar Dushi" shfaqte koncertet e saj nëpër qytetet e Kosovës, Maqedonisë dhe para studentëve apo shqiptarëve që jetonin e punonin në Beograd. Ishte viti jubilar i 500-vjetorit të lindjes së Skenderbeut dhe SHKA "Ramiz Sadiku" shfaqti dramën e saj për Skënderbeun në qytetet e Kosovës, Maqedonisë dhe vizitoi edhe



• Pjesëmarrës i mitingut të poezisë në Gjakovë, 1967

Beogradin. Ndërkaq Shoqata Studentore "Shkëndija" e Zagrebit kishte përgatitur recitalin me poezi tematike për Skënderbeun. Në këtë vit jubilar nëpërmjet Entit për përparimin e aktiviteteve kulturore të Kosovës, filmi për Skënderbeun i koproduksionit të Shqipërisë u shfaq edhe para studentëve shqiptarë e para shqiptarëve që jetonin e punonin në Beograd. Kjo gjenetatë e studentëve shqiptarë e Shoqatës Letrare-Muzikore "Përpjekja" ishte më aktive, entuziaste dhe e guximshme dhe la kujtime të pashlyera gjatë këtyre tubimeve në viset që i vizitoi. Në emër të Klubit Letrar të Gjakovës, Din Mehmeti, kryetari i këtij klubi letrar më ftoi dhe unë mora pjesë në Metingun e parë dhe të dytë tradicional të Poezisë në vitin 1967 dhe në vitin 1968 që mbahej më 9 maj në stadiumin "Shani Nushi". Nuk e harroj momentin kur publiku me duartrokitje të vazhdueshme kërkoi që të paraqitem sërish me vargjet e mia. Prezentuesi i metingut më dha shenjë që përsëri të dal para publikut. Duke iu afruar mikrofonit më erdhën në mëndje dhe i recitova vargjet, "Për Dibrën time derdh lot e të shtrenjtin gjak, por edhe për ty Gjakovë kurrë jo më pak", vargje që e lumturuan publikun e që bënë të buçasë stadiumi nga duartrokitjet frenetike.

Në kohën kur në Shërbimin e Përkthimeve erdhi për mua mendimi negativ, unë e takova z. Vahide Hoxha, bashkëshorten e z. Fadil Hoxha, e cila ishte deputete e Kosovës në Kuvendin Federativ, me nismën e angazhimit e të cilës u themeluan Shërbimi i Përkthimeve në Kuvendin Federativ dhe në

Këshillin Ekzekutiv Federativ ku isha unë i punësuar. Sapo e njoftova z. Vahide Hoxhën për mendimin negativ që kishte ardhur për mua nga Maqedonia, ajo më premtoi se çdo gjë do të rregullohet nëpërmjet z. Fadil Hoxha, bashkëshortit të saj që asokohe ishte edhe kryetar i Kryesisë të RSFJ-së, premtim të cilin edhe e realizoi. Pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë u ktheva në Dibër dhe sërish mora ofertën nga redaksia "Rilindja" që botohej në Tiranë dhe fillova të punoj si gazetar.

PUNA SI GAZETAR NË "FAKTI"

Puna ime si gazetar më tej vazhdoi në "Fakti", që nga fillimi e gjer në ndërprerjen e daljes së kësaj gazete të vyer, e cila në kohën dhe vendin e duhur bëri një informim të shkëlqyer dhe shumë të rëndësishëm për lexuesit dhe opinionin e gjërë, gjatë zhvillimit të luftës së UÇK-së në vitin 1999 në Kosovë dhe pas saj, si edhe gjatë zhvillimit të luftës së UÇK-së në vitin 2001 në Maqedoni dhe pas saj. Nëpërkëmbëzat e shtetit dhe mediokriteti e papërgjegjshmëria e partive politike shqiptare qenë vendimtare, që kjo gazetë e përditshme e vyer që kreu një mision të mrekullueshëm gazetaresk ta ndërpresë rrugëtimin e saj dhe ti lë pa punë një numër të madh të të punësuarve në këtë medium. Është për të theksuar se gazetara "Fakti" gjatë funksionimit të saj shërbeu si shkollë e mirfilltë e gazetarisë, ku Emin Azemi pranoi i kësaj gazete, redaksia dhe gazetarët e saj falë përkushtimit, misionit dhe punës së palodhur fituan përvojë dhe profesionalizëm

shumë cilësor, që u dëshmuua me faktin se shumica e redaktorëve dhe gazetarëve falë kësaj u sistemuuan dhe vazhduan të punojnë si profesionistë tejet të suksesshëm nëpër institucione tjera ku arritën të punosohen. Bashkëpunimi im si gazetar më vonë vazhdoi edhe në "Lajm", "Zhurnal", "Zëri", "Kosovapress", "Epoka e Re", "Illyria" në SHBA, dhe "Rrugë e Arbërit" në Tiranë.

Unë për asnjë çast nuk i shkëputa lidhjet me shokët nga Kosova. Komunikimin me shokët nga Kosova, natyrisht me ata që janë ende gjallë unë e mbaj edhe sot e kësaj dite. I kam njohur dhe kam patur konsideratë për letrarët Esad Mekuli, Sitki Imami, Hasan Mekuli, Vehap Shita, Ali Aliu, Ali Demë Jasiqi, Rexhep Hoxha, Maksut Shehu, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Din Mehmeti, Fahredin Gunga, Enver Gjergjaku, Rahman Dedaj, Ramiz Kelemndi, Qerim Ujkani, Teki Dervishi, Jakup Cerraja, Muhamed Kërveshi, Rifat Kukaj, Beqir Musliu, pastaj edhe për gazetarët Anton Pashku, Adem Skreli, Fehmi Baftiu, Ibrahim Kadriu, Jusuf Buxhovi etj. Ndërkaq nga veprimtarët politikë i kam njohur Mr. Ukshin Hotin, Fehmi Aganin dhe Adem Demaçin dhe Zekeria Canën për të cilët kam botuar edhe shumë shkrime dhe i kam kuptuar mirë e thellësisht konceptet e tyre gjeopolitike dhe rrugën për realizimin e të drejtave mbarëshqiptare.


Pjesa më e madhe e punës sime i është kushtuar Kosovës. Hapat e parë në gazetari i bëra në gazetën "Rilindja" të Prishtinës në nëntor të vitit 1967 kur në Dibër ndodhi tërmeti shkatërrues me ç'rast informoja rregullisht për

gjendjen pas tërmetit, ndërsa për tekstin e reportazhit "Dibra natën e Vitit të Ri 1967" mora shpërblym dhe redaksisë. Me shkrimet e mia informoja me korrektësi se kamionët e parë me bukë ditën e tërmetit në Dibër erdhën nga Kaçaniku me çka i hedhja poshtë pretendimet e mediave maqedonase që deshin ta mbulojnë këtë të vërtetë. Asokohe autoritetet maqedonase morrën qëndrim të ndalojnë ndihmat që vinin nga Kosova, por menjëherë reagoi Sali Bajra, kryetar i Kaçanikut duke e bllokuar rrugën Kaçanik-Shkup, gjë që qe e efektshme dhe Maqedonia i hoqi pengesat për arrijtjen e ndihmave nga Kosova në Dibër. Duke shikuar se autoritetet maqedonase llogarinë rrjedhese për ndihmat në Dibër e hapën në Shkup dhe se në Dibër nuk arrinin ndihmat e nevojshme, me ndihmën e gazetarëve të "Rilindjes" Maksut Shehu dhe Fehmi Baftiu, i dërguam informata dhe foto Salih Vzhvhdit, gazetarit të "Vjesnik u Srijedu" në Zagreb, i cili menjëherë në faqen e parë të kësaj gazete botoi shkrimin me titull "Zaboravljeni Debar", tekst që zgjoi interesim të madh dhe e detyroi që brenda dy ditëve Dibrën ta vizitojë Mika Shpiljak, kryeminitër i atëhershëm i ish Jugosllavisë, dhe pas kësaj vizite në aspektin e ndihmave gjendja në Dibër e fshatra u përmirësua dukshëm.

Tashmë që kam shkelur në vitin 73 të moshës sime dhe falë ndihmës së Zotit, përkundër sëmundjes së rëndë jam duke vazhduar punën e gazetarisë me shkrimin e kolumnave në "Koha" dhe "Bota Sot", gjithnjë në mesin e shokëve kosovarë.

Mustafi u shpall lojtari i ndeshjes ndaj Liverpoolit

Shkodran Mustafi bëri ndër paraqitjet më të mira në kohët e fundit duke u shpallur lojtari i ndeshjes i Arsenalit në barazimin 1-1 ndaj Liverpoolin në kryendeshjen e javës në Premierligë të shtunën. Alexandre Lacazette me një gol të vonshëm e shpëtoi Arsenalin nga humbja, pasi Liverpool po udhëhiqte falë golit të James Milnerit, por qendërmbrojtësi shqiptari i Gjermanisë ishte më i miri në skuadrën e Unai Emeryt. Mbrojtësi nga Gostivari ka thënë se është krenar me bashkëlojtarët e tij që nuk u dorëzuan deri në fund, në një postim në rrjetin social Twitter. "Krenar me ekipin dhe shpirtin e treguar. Nuk kam asgjë më shumë për të thënë", shkroi Mustafi në Twitter.



Shaqiri i përgjigjet kritikëve: Unë meritoj respekt

Xherdan Shaqiri i ka goditur kritikët, duke ua kujtuar se ai është fitues i shumë trofeve, përfshirë i Ligës së Kampionëve me Bayern Munichun, si dhe ka insistuar se duhet të mbahet në mend për sukseset dhe jo për rënien nga Premierliga me Stoke Cityn sezonin e kaluar. Kosovari i Zvicrës, i cili iu bashkua Liverpoolit këtë verë për rreth 15 milionë euro pas rënies së Stoke nga Premierliga, ka thënë se duhet të mbahet në mend për trofetë që i ka fituar me Baselin dhe Bayern Munichun, e jo për rënien nga liga sezonin e kaluar me Stoke. Po ashtu, Shaqiri ka reaguar ashpër ndaj sugjerimeve se Jurgen Klopp e ka transferuar atë thjesht për ta plotësuar numrin e lojtarëve në Liverpool. 27-vjeçari nga Kosova ishte pjesë e skuadrës së Bayern Munichut që u shpall kampione evropiane më 2013. Ai i ka fituar dy tituj të Bundesliga, dy Kupa të Gjermanisë dhe Kupën e Botës për Klube me gjigantin gjerman Bayern, si dhe tre tituj të Zvicrës me Baselin. "Rënia nga liga me Stoke ishte përvojë shumë e keqe për klubin dhe mua dhe shpresoj se klubi do të rikthehet në Premierligë. Por, përkundër asaj që ndodhi atje, unë jam fitues i Ligës së Kampionëve. Mendoj se kjo meriton respekt", ka thënë Shaqiri. "Njerëzit duhet ta mbajnë në mend se ku kam luajtur më parë, cilësitë që i posedoj, si dhe atë që e kam arritur në futboll. Kam luajtur për njërin prej klubeve më të mëdha në botë, Bayern Munich, dhe përsëri po luaj për një klub shumë të madh, prandaj nuk ndiej presion në fanellën e Liverpoolit", shtoi ai. Shaqiri ka pasur edhe një periudhë të shkurtër te gjiganti italian Inter.

LIGA E PARË - "KUQEZINJTË" MARRIN KREUN E TABELËS

SHKËNDIJA FITON DERBIN NDAJ SHKUPIT

Shkëndija ka mundur Shkupin me rezultatin 3:0 në ndeshjen derbi të javës së 13 në elitën e futbollit vendor, pas së cilës tashmë ka marrë edhe kryesimin në renditjen tabelore, pas barazimit të Vardari ndaj Bellasicës 1:1. Renova falë përmbysjes gjatë pjesës së dytë në Shkup me rezultatin 2:1 mundi Makedonija GJ.P

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 4 nëntor - Janë zhvilluar ndeshjet e javës së 13 në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë. Derbi i javës u zhvillua në qytetin e Tetovës, ku u përballen dy skuadrat shqiptare, Shkëndija dhe Shkupi. Kampioni aktual edhe pse në radhët e veta nuk kishte lojtarin më të mirë Besart Ibraimi arriti që shënon fitore me rezultatin 3:0 ndaj ekipit të Shkupit. "Kuqezinjtë", në avantazh kaluan që në minutën e 15 të takimit me anë të Samir Fazli. Pas golit të parë ishin përsëri



nikoqirët që dominon në fushën e lojës. Kështu që pesë minuta para përfundimit të pjesës së parë Shkëndija shënoi edhe golin e dytë. Pas një krosimi të mirë nga ana e majtë ishte Izair Emini i cili me kokë çoi topin në rrjetën e portierit shkupjan, Igor Angelovski. Në fraksionin e dytë nikoqiri arriti që të shënon edhe golin e tretë. Në minutën e 82 ishte Armend Alimi që vulosi rezultatin përfundimtar Shkëndija - Shkupi 3:0. Më këtë fitore skuadra "kuqezi" ka arritur që të merr kreun e tabelës, pasi lideri i deritanishëm Vardari nuk arriti që të merr tre pikët ndaj Bellasicës, por vetëm duke luajtur barazi 1:1.

Ekipi i Vardarit ishin të parët që kaluan në avantazh pas një supergoli të Darko Micevskit në minutën e 30 të pjesës lojës së parë, mirëpo, Bellasica nuk u dorëzua dhe kështu në minutën e 72 shënuan golin e barazimit me anë të ish lojtarit të Vardarit, Filip Ivanovski. Nga ana tjetër, skuadra e Renovës me një lojë të bukur në pjesën e dytë ka arritur të merr fitore në terrenin e vështirë të Makedonija GJ.P. Ishin nikoqirët nga Shkupi që kaluan të parët në avantazh, ku në minutën e 15 me anë të Dejan Tanturovski shënuar për 1:0. Më këtë rezultat ekipet shkuan në pushim. Gjithçka ndryshoi në pjesën e dytë, skuadra e te-

tovere për vetëm dy minuta arriti që të përmbys rezultatin. Së pari Vlatko Stojanovski në minutën e 60 barazoi shifrat në 1:1, ndërsa vetëm dy minuta më vonë Emran Ramadani shënoi golin e fitores. Ekipi i Renovës pas kësaj fitore ngjitet në vendin e gjashtë në tabelë me 16 pikë të tubuara. Akademija Pandev edhe më tej vazhdon me ndeshjet e mira. Ekipi nga Strumica kësaj herë në terren vendas arriti që të merr fitoren ndaj Rabotniçkit me rezultatin minimal 1:0. Ekipi i Akademija vazhdon të mbaj vendin e tretë në tabelë me 22 pikë të tubuara. Me rezultatin 2:0, skuadra e Pobodës ka mposhtur Sileksin.



Shkup, 4 nëntor - Të shtunën janë zhvilluar ndeshjet e javës së 12 në Ligën e Dytë-Perëndim. Derbi i javës është zhvilluar në qytetin e Gostivarit, ku janë takuar vendasit Gostivari dhe Genç Kalemler.

Mysafirët kanë arritur të marrin fitoren me rezultatin 2:3, ndërsa për këtë fitore më meritator ishte portieri i ekipit mysafir Amir Jashar, i cili në minutat shtesë priti penaltinë e Florent Osmanit, duke

LIGA E DYTË

Genç Kalemler fiton ndaj Gostivarit

i siguruar në këtë mënyrë fitoren skuadrës së tij. Ekipi i Korabit ishte mysafire e Vëllazërimit në Kërçovë dhe arriti ti shënon fitore me rezultatin e thellë 4:1. Lideri aktual Struga Trim Lum në Tetovë barazi 1:1 me Teteksin, ndërkaq, Pelisteri falë mudi Goblen Junior me rezultatin 2:0. Nga ana tjetër në Ligën e Dytë-Lindje, lideri i tabelës Boreci ka vazhduar

serinë e fitoreve, këtë herë në terren mysafire mposhtën Sasan me rezultat 2:1. Skuadra e Kit GO pa problem fitoi ndaj Varadar Negotino me rezultat 2:0, Tikveshi me rezultatin 4:2 mundi Pllaçkovicën, Bregallnica fitore me rezultatin 2:1 si mysafire e Partizan Obrshani dhe Detonit Zhunior pësoi humbje në terren vendas nga Kozhufi me rezultati 1:3. (FN)

Haruni: Pa kundërshtar nuk fitohet titulli

Shkup, 4 nëntor - Me zhvillimin e raundit të tetë, ka përfunduar kampionati shtetëror në boks. Në konkurrencën e të rinjve kampion ka dalë Bargalla e Shtipit. Renditja përfundimtare e klubeve të boksit ka nxitur reagimin e trajnerit të KB "Shkupi", Naser Haruni i cili në rrjetet sociale ka

komentuar këto rezultate. "Mbaroj kampionati ekipor i Maqedonisë në boks për vitin 2018. KB Bargalla nga Shtipi u shpall kampion i Maqedonisë për të rinj jo që ishin më të mirët se në, por boksierët ton më të mirë nga 8 xhiro që u mbajtën në këtë kampionat Jasni Lama, Hurmet Jonu-

zi, Ardijan Azemi gjithë kohën nuk kishin kundërshtar edhe kjo ishte vendimtare që Bargalla të shpallen kampion por ne jemi krenar me djem tonë dhe ne shumë mirë e dimë edhe ata e dinë se ne jemi shumë më të mirë se ata, Urime djema", ka shkruar Haruni.



Deri tani Interi ka pësuar vetëm 6 gola në kampionat, si asnjë skuadër tjetër dhe për statisticienët kjo është një e dhënë mjaft e rëndësishme, pasi thuhet gjithmonë Seria A është fituar nga ekipi me mbrojtjen më të mirë

INTERI ME MBROJTJEN MË TË MIRË NË EVROPË



Asamoah dhe Vrsaljkos, ka rritur jo vetëm konkurrencën dhe alternativat, por edhe cilësinë në skuadër. Deri tani Interi ka pësuar vetëm 6 gola në kampionat, si asnjë skuadër tjetër dhe për statisticienët kjo është një e dhënë mjaft e rëndësishme, pasi thuhet gjithmonë Seria A është fituar nga ekipi me mbrojtjen më të mirë. Përmirësimi i grupit evidentohet edhe te numri i lojtarëve që Spalletti ka përdorur nga minuta e

parë, që janë plot 20 të tillë, krahasuar me 14 në një sezon më parë, kur teknikut zikaltrë i mungonin alternativat. Pasja e një organike të pasur, i ka dhënë mundësi Spalletti që të hedhë në fushë thuhet gjithmonë një skuadër të freskët, pavarësisht impenjimeve të shumta, si në kampionat, ashtu edhe në Ligën e Kampionëve. Dhe pikërisht te kjo e fundit, zikaltrit do të presin Barcelonën të martën të mbrëmje, në një sfidë ku Spal-

letti ka kërkuar që skuadra të luajë me autoritet dhe të tregojë vërtetë se ka bërë një hap cilësor shumë të rëndësishëm. Sfidat e parë ndaj katalanëve u humb 2-0 në "Camp Nou", rezultat ky i pranueshëm për një ekip si zikaltrit, shumica e të cilëve luajnë për herë të parë këtë sezon në Champions, pro ndeshja e të martës në mbrëmje, do të jetë një test që mund të thotë se sa larg mund të shkojë kjo skuadër.



Wayne Rooney rikthehet të luajë me kombëtaren e Anglisë

Wayne Rooney do të bëjë një rikthim të bujshëm me fanellën e kombëtares së Anglisë. Sipas të përditshmes britanike "The Sun", sulmuesi legjendar i Anglisë do të zhvillojë edhe një ndeshje të fundit me fanellën e "3 luanëve", më 15 nëntor, në miqësoren që Anglia do të zhvillojë ndaj Amerikës në stadiumin "Wembley".

33-vjeçari Rooney, që ka luajtur me Manchester United dhe Everton në Premier League, këtë sezon "emigroi" në Amerikë, për të luajtur me skuadrën e DC United, duke realizuar 12 gola dhe shkëlqyer sërish në fushë. Sulmuesi është tërhequr nga kombëtarja vitin e kaluar, por pritet që ai të rikthehet për këtë ndeshje miqësore ndaj shtetit që e ka "adoptuar", ku do të grumbullohet nga trajneri Southgate. Sulmuesi ka luajtur 119 ndeshje me kombëtaren e Anglisë në karrierën e tij (në 22 takime ka qenë kapiten), ku ka arritur 71 fitore, 29 barazime e 19 humbje, duke realizuar edhe 53 gola, një rekord.

Kjo miqësore me Amerikën do të zhvillohet për bamirësi dhe një nga shoqatat që do të përfitojnë është edhe ajo e futbollit, "Wayne Rooney Foundation".

Xavi: Futbolli i sotëm i mërzitshëm për sy



Ish-mesfushori i Spanjës dhe Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë se shumica e top klubeve evropiane luajnë futboll të mërzitshëm për syrin e teleshikuesve. Xavi foli në programin "Tot Costa" në Radio Catalunya për top ekipet dhe stilin e tyre të lojës. Ai ka thënë se shumica e ndeshjeve që i sheh në TV i duken të mërzitshme. "Duhet ta pranoj se shumica e ndeshjeve që i shikoj në TV janë të mërzitshme. Shumë ekipe janë të ngadalta dhe luajnë futboll monoton. Ekipet që luajnë me formacion 4-5-1 më mërzis; nuk duan topin në këmbë", tha Xavi. Ai beson se kjo i bën mirë pasi kështu do të mësojë për gjërat që do t'i bëjë kur të bëhet trajner. "Unë kam ide të qarta sesi dua që ekipi im të luajë: ta dominojë ndeshjen, ta mbajë topin dhe të krijojë dhe të jetë aktiv. Kështu ka qenë për mua në Barcelonë", shtoi ai.



Guardiola: Nuk u kam thënë kurrë lojtarëve të mi ta bëjnë këtë gjë

Pep Guardiola është transformuar nga mjeshtri i "tiki taka" në mjeshtrin e mbrojtjes, pasi skuadra e Manchester City nuk pëson gol në 6 ndeshje radhazi në Premier League dhe në rast se "qytetarët" nuk do të pësojnë gol as në ndeshjen ndaj Southampton do të vendosin rekord. Në 10 ndeshjet e luajtura deri më tani, City ka pësuar gol vetëm në 3 takime, çka e projektton skuadrën e trajnerit spanjoll drejt thyerjes së rekordit

të Jose Mourinho, që me Chelsea, në vitin 2004-2005 pësoi vetëm 15 gola. Çka tregon se trajneri Guardiola nuk punon vetëm për sulmin, por edhe për mbrojtjen, çka e bën skuadrën e City një ekip të "pastër", që nuk shkakton shumë faulle. Trajneri spanjoll ka hedhur kështu poshtë akuzat e Gery Neville, sipas së cilit lojtarët e City luajnë "pisët", duke shkakuar faulla në mesfushë në momentin e kundërsulmit të skuadrave rivale.

"Nuk u kam thënë kurrë lojtarëve të mi të luajnë "pisët". Është normale që kur lojtari kundërshtar ka topin unë do të bëj maksimumin për t'ia marrë atë, duke ushtruar presion apo edhe duke e rrëzuar për të mos e lënë të realizojë. Ky nuk është një sekret. Ky është futboll, ndonjëherë shkon me vonesë dhe bën një ndëhyrje të gabuar, por asnjëherë nuk u them lojtarëve të mi të bëjnë faulla të rëndë apo të qëllimshëm", tha Guardiola.

Allegri: Po fitojmë, por pësojmë shumë gola

Trajneri Max Allegri është i kënaqur me fitoren që skuadra e Juventusit arriti ndaj Cagliari, duke ruajtur distancën me rivalët. Me 31 pikë nga 33 të mundshmet pas 11 javë kampionat, skuadra e Juventusit është thuhet se e përkryer, pasi ekipi krijon shumë raste dhe shënon po shumë, por diçka nuk funksionon në mbrojtje. "Fitojmë por edhe vuajmë shumë. Kjo është e kotë",



thotë Allegri që shprehet se diçka nuk funksionon në mbrojtje. "Duhet të mbrojmë më mirë, pasi kohët e fundit po pësojmë shumë

gola, në çdo ndeshje. Kjo nuk është normale. Duhet të koordinojmë më mirë veprimet, të mbrojmë më shumë e pësojmë më pak gola. Skuadrat arrijnë të na shënojnë dhe të vënë në vështirësi, pasi lejojmë rivalët të krosojnë shumë në zonën tonë. Cagliari rrezikoi të na barazojë dy herë, çka do të ishte fatale dhe e vështirë për ta fituar ndeshjen", u shpreh Allegri.

"TITULLI I PISTOLETAVE", GENOA RIHAP ÇËSHTJEN E GROPOSUR PREJ THUAJSE NJË SHEKULLI

93 vjet më vonë është një ndeshje futbollit që ende ngjall diskutime në Xhenova. Bëhet fjalë për finalen e kampionatit 1924-25, ose më mirë, pesë ndeshjet që i dhanë mundësi Bologna-s që të fitonte titullin e parë italian, në dëm të Genoa



Historia është gjithmonë pjesa më e bukur për t'u studiuar, për të kuptuar në detaj fakte reale, ngjarje që kanë shënuar një epokë, mistere të pazgjdhura, por edhe ndodhi që fshehin një pëlthurë polemike. 93 vjet më vonë është një ndeshje futbollit që ende ngjall diskutime në Xhenova. Bëhet fjalë për finalen e kampionatit 1924-25, ose më mirë, pesë ndeshjet që i dhanë mundësi Bologna-s që të fitonte titullin e parë italian, në dëm të Genoa. Ai që ka kaluar në histori ose në dosje si "titulli i pistoletave" është në fakt një plagë për tifozët kuqeblu që tani, pas shumë vitesh, klubi do të përpiqet të shërojë njëherë e përgjithmonë. Ashtu si u shpjegua edhe në TeleNord nga drejtuesi i klubit më antik në Itali, Tonino Bettanini, Genoa do të prezantojë javët e ardhshme një dosje në FIGC (federata italiane) me qëllimin që t'i jepet titulli i atij sezoni. Fitili është ndezur nga publikimi i librit të shk-

ruar nga Giancarlo Rizzoglio, "Ylli që iu mohua Genoa-s së madhe", që ka zbuluar disa detaje mbi parregullsitë e epokës për të favorizuar Bologna-n. Presidenti i asaj kohe ishte Leandro Arpinati, hierark fashist shumë pranë Mussolini, që vitet më pas do të bëhej president i federatës italiane të futbollit. Fitorja e Bologna-s do të favorizohet nga presione të jashtme për t'i bërë një nder Arpinatit. Faktet rreth asaj ndeshje, në fakt, ishin tronditëse. Pasi mbërritën në finale të grupit të Veriut për të shkuar në finalen e madhe kombëtare kundër Alba Roma, dy formacionet kuqeblu duhet të luanin pesë ndeshje mes tyre për të përcaktuar se cila do të arrinte kualifikimin. Pas fitores së Genoa-s 2-1, Bologna përmbysi gjithçka me një rezultat të njëjtë. Por, në sfidën e tretë, që u luajt në fushën neutrale të Milanos, presionet e futbollistëve të Bologna-s ndaj arbitrit

dhe sidomos prania kërcënuese të disa drejtuesve të armatosur me pistoletë detyruan federatën që të ndërronte seli dhe ta çonte sfidën në Torino. Por, nuk shkoi më mirë. Madje, sfida e katërt u parapri nga disa përleshje të dhunshme mes dy tifozëve që përfshinë disa zona të qytetit. Madje, pati edhe të shtëna. Në fushë, sfida përfundoi në barazim, duke detyruar në një ndeshje të pestë që u luajt në mëngjesin e 9 gushtit në Milano me dyer të mbyllura. Ishte Bologna ajo që fitoi ndaj Genoa-s duke arritur të shkojë në finalen e madhe për titull, mes polemikave dhe akuzave të ekipit ligur. Kontestime që gjetën veshë shurdhë për thujse një shekull, por që tani mund të kthehen në skenë, duke i dhënë Genoa-s kështu fitimin e atij ylli të artë, simbol i 10 kampionateve të fituar. Një triumf që kanë ndjekur prej shumë vitesh.



Greqia "kopjon" Shqipërinë, një trajner italian për kombëtaren

Federata Greke e Futbollit synon të sjellë një trajner italian në krye të ekipit kombëtar. Pas shkarkimit të Michael Skibbe, drejtuesit e futbollit grek kanë shënjestruar si pasardhësin e tij trajnerin e njohur italian Beppe Iachini. Këtij të fundit i është propozuar një kontratë 2-vjeçare, me opsion për ta rinovuar atë edhe me 2 vite të tjera. Një propozim që ka befasuar por edhe kënaqur trajnerin Iachini, që ka marrë disa ditë kohë për të reflektuar e më pas do të njoftojë Federatën. Kombëtarja i është besuar aktualisht Angelos Anastasiadis, por kjo zgjedhje është e përkohshme deri në caktimin e trajnerit të ri, që me shumë gjasa do të jetë Iachini, pa skuadër që kur u shkarkua nga detyra si trajner i Sassuolo. Trajneri Beppe Iachini nuk dëshiron të marrë një vendim të nxituar, pasi po shqyrton edhe mundësi të tjera, që mund të konkretizohen së shpejti. Në rast se ai pranon, do të bëhet trajneri i dytë italian që drejton Greqinë, pas Claudio Ranieri (korrik-nëntor 2014).

Publicitet

Në bazë të nenit 20-g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16,35/18), neni 22, ndërsa në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 74/15, nr. 129/15, nr. 167/15 dhe 27/16) dhe nenin 143 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16 dhe 163/17), dhe pajtimi me shkrim nr. 18-12747/2 nga 24.10.2018, për përkëdhelës, e parashtruar nga Ministria e financave të RM, si dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Detelinka" - Kriva Pallankë nr. 0101-145/2 nga 07.09.2015, Drejtori i Institucionit publik komunal për fëmijë - Cerdhja për fëmijë "Detelinka" Kriva Pallankë, publikon:

SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim për kohë të pacaktuar të punës

1. Përkëdhelës 1 (një) realizues

- Arsim të mesëm katërvjeçar të mbaruar
- Me ose pa përvojë pune
- Licencë valide për përkëdhelës
- Orari ditor i punës: 8 orë (nga 08:30 - 16:30)
- Orari javor i punës: 40 orë (nga e Hëna deri të Premten)
- Neto pagesa fillestare: 15.477,00 denarë

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përcaktuara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta zyrtare e RM nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015 и 150/2015,27/2016, 163/17) Përveç fletëparaqitjes, kandidatët nën numrin rendor 1. Përkëdhelës duhet të parashtrorjnë edhe dokumentet në vijim:

Dokumentet e duhura për paraqitje:

- fletëparaqitje për punësim
- certifikatë të lindjes
- certifikatë të shtetësisë së RM
- vërtetim mjekësor që personi është psikikisht - fizikisht i shëndoshë
- vërtetim që nuk ka të shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- vërtetim që nuk i shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese
- diplomë për arsim adekuat të mbaruar në origjinal ose kopje e vërtetuar,
- të plotësojë edhe kushte tjera të përcaktuara në aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e duhur të parashtrohen në një zarf të mbyllur pa ndonjë shenjë në Zyrën e IPKÇF "Detelinka" Kriva Pallankë ose përmes postës në adresën : rr. "Sv Joakim Osogovski" nr. 51, 1330 Kriva Pallankë, me shenjë të vetme
"Për shpalljen publike për punësim me kohë të pacaktuar"

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve zgjat **3 ditë pune** nga dita e publikimit në shtypin ditor, duke mos e llogaritur ditën e publikimit në shtypin ditor. Përzgjedhja do të bëhet në afat prej 8 (tetë) ditëve pas skadimit të afatit për paraqitje. Fletëparaqitja jo e plotë, jo e rregulluar dhe e dorëzuar me vonesë nuk do të jetë lëndë për mbikëqyrje.

IPKÇF "DETELINKA" Kriva Pallankë

Lëkunden sërish pozitat e Kovac

Trajneri Niko Kovac ka mbetur i zhgënjyer nga barazimi 1-1 që Bayern Mynih arriti në "Allianz Arena" ndaj Freiburg, rezultat që largon edhe më shumë bavarezët me Borussia Dortmund në krye të renditjes. Një gol i miqve minutën e fundit të ndeshjes ka befasuar kampionët e Bundesligës, që kishin vetëm 10 minuta që kishin shënuar me Serge Granbry. Ky rezultat ka vënë sërish nën presion skuadrën bavareze dhe trajnerin Kovac, që sheh të rrikthehen sërish fantazmat e një shkarkimi të mundshëm. "Kjo është ndeshja e dytë që humbasim pikë në minutën e fundit, pasi kjo gjë ndodhi edhe ndaj Augsburg. Kemi falur 4 pikë, që tashmë na mungojnë në renditje. Jam shumë



i inatosur me skuadrën por edhe i mërzituar me mënyrën se si po falim pikë. Pjesën e dytë e zhvilluam tërësisht në zonën e Freiburg, por realizuam vetëm një gol, që nuk mjaftoi, ndaj duhet kujdes në të ardhmen. Ky është sporti e jeta vazhdon, pasi tani duhet të menjohet për ndeshjen e radhës, pas 3 ditësh, në Champions League", tha Kovac.

Barça pret shumë nga Dembele

Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde thotë se klubi katalonjas ka pritje të larta për sulmuesin Ousmane Dembele, ndërsa e lavdëroi paraqitjen e francezit në fitoren 3:2 ndaj Rayo Vallecanos. Dembele u inkuadrua në lojë në minutën e 52-të, ndërsa derisa ekipi i tij po mposhte 2:1, ai realizoi golin e barazimit në minutën e 87-të. "Ne presim shumë nga ai.



Dembele mund të jetë vendimtar dhe sot (e shtunë) ai na ndihmoi me një gol të rëndësishëm që na mundësoi që të shënonim tjetrin", deklaroi Valverde. Dembele, i cili ishte transferuar te Barcelona në vitin e kaluar nga Borussia Dortmundi, është paraqitur në 14 ndeshje deri më tani këtë edicion dhe ka realizuar 6 gola dhe 3 asistime.

Publicitet

Shesim tokë ndërtimi - 9000m²
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m².
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

FUTBOLL NË QYTETIN “PA DIELL”, ATY KU TYMUESIT NUK JANË... KOREOGRAFI

Ku ka jetë dhe frymë, ka edhe... futboll. Jo më kot, konsiderohet sporti më popullor në planet. Bota është e përbërë nga shumë kombësi, kultura, zakone, gjuhë, por edhe tradita e besime fetare. Ajo që i bashkon është mënyra për t'u argëtuar, zbavitur dhe për të rendur pas një topi. Sigurisht, diferenca, më pas, përbëhet nga zhvillimi ekonomik. Në hartën e globit, ka vende të kushtëzuara nga temperaturat, moti, por edhe kushtet e tjera. Por, topi nuk ndalon. Dhe, nëse luhet në Groenlandë, apo ishuj shumë të vegjël, atëherë pse të mos luhet edhe në Mongoli?! Jemi në Azinë Lindore. Zemra e atij territori të dendur ku u pozicionua edhe Perandoria Mongole nën shpatën e Gengis Khan dhe e pasuar nga Kublai Khan. Toka që gjejnë rrënjë në historinë mijëvjeçare të populluar nga luftëtarë të pathyeshëm. Vende misterioze dhe horizonte të pafundme. Shkretëtira e papërshkueshme e Gobit, aty ku syri e humbet horizontin dhe toka bashkohet me qiellin pa një kufi të saktë. Për shekuj me radhë, popujt shtegtarë kanë kaluar në këto fusha, duke ndjekur stinët mes temperaturave +40 gradë celsius te -40 gradë celsius, me një objektiv: të mbijetojnë. Qendra kryesore është kryeqyteti Ulan Bator. Emër që personifikon Heroin e Kuq, ose çliruesin kombëtar, Damdin Suhbaatar. Qytet prej më shumë se 1,3 milionë banorësh, 1350 metra mbi nivelin e detit në zonën jugore të vendit, në fushën e lumit Tuul në këmbët e malit Bogd Khan Uul. Është qendra nevralgjike më e zhvilluar e rrjetit rrugor dhe sidomos atij hekurudhuor, transmongolian, që lidhet me hekurudhën veriore transiberiane (Ulan-Ude, në Rusi) me jugun rrjetit qendror kinez (Zhining, Kina). Poli unik i referimit në nivel kulturor dhe financiar, por edhe udhëheqës, qendra më e madhe industriale e shtetit. Kryeqyteti ka asistuar me një fenomen të urbanizimit në dekadat e fundit për shkak të industrializimit ndonjëherë të diskriminuar që ka sjellë krijimin e shumë distrikteve ekstraurbane ku jeton pjesa më e madhe e popullsi-



Në hartën e globit, ka vende të kushtëzuara nga temperaturat, moti, por edhe kushtet e tjera. Por, topi nuk ndalon. Dhe, nëse luhet në Groenlandë, apo ishuj shumë të vegjël, atëherë pse të mos luhet edhe në Mongoli



së. Një periferi në shtëpi druri dhe çadra të karakterizuara nga varfëria e përhapur. Pra, jashtë janë stepat, ndërsa brenda një nga qytetet më të ndotura në botë për djegien e qymyrit dhe drrurit, që e bëjnë një vend me atmosferë ferri, sidomos gjatë dimrit. Një mjegull shumëvjeçare dhe një erë e mprehtë e smogut pushtojnë rrugët, duke errësuar dritën e diellit. Pikërisht këtu ngrihet një sta-

dium unik në llojin e tij. Impianti i skuadrës më të rëndësishme dhe fituese në Mongoli: Erchim FC. I themeluar në vitin 1948 nga një grup inxhinierësh të centralit elektrik kryesor të Ulan Bator, është bërë pjesë e futbollit profesionist në vitin 1994, si klub në pronësi të TES4 (Centrali Termik nr.4). Ka fituar dhjetë herë Premier League e Mongolisë dhe në 2017-n ishte klubi i parë mongol që u kualifikua për

Champions aziatik, AFC Cup. Vendndodhja e stadiumit është disa qindra metra nga ai që mund të jetë centrali më i madh i qymyrit në Mongoli, ku janë verifikuar shumë keqfunksionime dhe aksidente të shpeshta. Ndërkohë, impianti gjeneron edhe sot ndotje në nivele të larta. Ajo që të prezantohet përpara syve është një imazh i një filmi post-apokaliptik. Një fushë futbollit sintetike me 2000 vende, e rrethuar nga mure të vogla betoni dhe tribuna druri. Në sfond, malet dhe qendra gjigante e centralit që “pështyn” tym vazhdimisht. Këtu mund të zhytesh në një shkreti të plotë, midis pluhurit të rrugëve të pashtuara dhe një smogu që ngjitet. Simbol i pangatërueshëm i Mongolisë që mes kontraktave kërkon rrugën e modernizmit dhe progresit. Në nivel ekonomik-social, ashtu si edhe futbollistik. Në nivel klubesh, Premier League Mongole është krijuar në vitin 1996, për të reformuar kompeticionin e krijuar në 1955. Kampionati zhvillohet mes majit dhe tetorit, për shkak të klimës së ashpër. Nga viti 2014, Federata futbollistike mongole i ka dhënë jetë dy kategorive të ulëta për të tentuar zgjerimin e skuadrave pjesëmarrëse. Dy vite më parë, numri i skuadrave të Premier League është çuar në 10. Janë depozituar më pas shoqatat e 21 provincave dhe po aplikohen disa programe në shkolla në favor të futbollit të rinjve dhe femrave, si

për të zhvilluar lëvizjen në mënyrë globale, ashtu edhe për të marrë frymë më shumë dhe zgjeruar kampionatin. Jo vetëm kaq, por është arritur edhe akord komercial si ai i vitit 2015 me birrën Khurkhree. Një akord që çoi futbollin mongolez në tv, në transmetimet e ndeshjeve për NTV. Megjithatë, rezultoni e vështirë që futbollit të rritet po aq sa mundja, sumo, goditja me hark. Sa i përket kombëtares së futbollit të Mongolisë, rezultatet historike janë të ulëta. E krijuar në vitin 1959, nuk ka zhvilluar kurrë një turne ndërkombëtar nga viti 1960 deri në 1998 dhe sot mban vendin e 198-të në renditjen FIFA. Kombëtarja e vogël është eliminuar nga Timor i Lindjes në turin e parë për Botërorin Rusi 2018. Problemet janë ende të shumta. Në radhë të parë, dimri i gjatë dhe i ftohtë, që kushton edhe strukturat. Jo vetëm kaq, por shkalja e korrupsionit mbetet e lartë, me 80% e fondeve të FIFA-s që marrin tjetër rrugë dhe vetëm në futboll që nuk investohen. Faktorët e rritjes qëndrojnë dhe të bëjnë të shpresosh. Nuk mbetet vetëm se të pritët dita kur një fëmijë i atij brezi luftëtarësh, të uritit nga rënia e Bashkimit Sovjetik, që luan mes rrugëve me pluhur të Ulan Bator apo në tokat e pafundme të stepave mongole, duke ëndërruar për të arritur vagonët e Transmongolisë drejt stadioneve të Rusisë dhe Kinës, të bëhet një kampion me famë botërore.



Sa më shumë
përkrahje dhe
privilegje që i ofrohet
diasporës, aq më
shumë përfitime do të
ketë Kosova si shtet

OPSIONET PËR RRITJEN E INVESTIMEVE TË DIASPORËS NË KOSOVË

Shumë shpesh pyesim veten si mund diaspora, ata të cilët emigrojnë nga vendet në zhvillim, ta mbështesin zhvillimin e vendit të tyre? A duhet ata ta ndajnë rrogën e tyre me shtetin apo edhe talentet dhe aftësitë e tyre? A mundën emigrantët dhe migrimi ta ndihmojnë shtetin dhe ta shtyj përpara progresin e qëllimeve të zhvillimit të tij?

Gjatë 38 viteve të fundit mund të thuhet se roli i diasporës në politikën internacionale është rritur dukshëm. Nëse analizojmë politikën aktive të komuniteteve nga diaspora, siç janë: asociacionet e hebrenjëve, grekëve, kubanezëve dhe armenian-amerikanëve, mund të shohim se si ata e reprezentojnë dhe sa fuqishëm llobojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Poashtu, grupet e diasporës iraniane kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në inkurajimin e militarëve amerikan për të intervenuar në Irak në vitin 2003. Mund të themi se kjo është shumë e ngjashme, në mos e njëjta situatë me çka ka ndodhur me diasporën e Kosovës për intervenimin e Amerikës dhe Europës në luftën e vitit 1998.

Kjo na tregon se si diaspora luan një rol mjaft të rëndësishëm në politikën e një vendi. Për shembull, vendet si Izraeli dhe Armenia e konsiderojnë diasporën e tyre si shumë aktive në strategjitë politike. Vendet si India, Filipinet i gëzojnë kontributet masive që diasporat e tyre bëjnë përmes remitançave vjetore.



Ndërkohë, një studim i bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2013, shpjegon se 43% e familjeve kosovare kanë pjesëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit, përderisa 22.4% e këtyre kanë pranuar remitanca nga familjarët e tyre gjatë vitit 2012.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës thonë se në vitin 2017 është shënuar rekord i dërgimit të parave nga diaspora në Kosovë krahasuar me vitet paraprake. Në vitin 2017, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, janë dërguar 759 milionë euro nga diaspora në Kosovë. Që nga viti 2011, remitancat janë vazhdimisht në rritje. Rënie të remitançave kishte nga viti 2008 deri në vitin 2011, vite këto kur bota ishte në krizën globale financiare.

Investimet e diasporës në Kosovë konsiderohen si investime të huaja direkte. Pra, një pjesë të investimeve të huaja e bëjnë diaspora, që tregojnë rolin e rëndësishëm edhe

në hapjen e vendeve të reja të punës. Nga një anketim që është bërë për bizneset kosovare, tregojnë se 25% e bizneseve janë themeluar dhe kanë një mbështetje të pjesshme ose edhe të të plotë nga diaspora.

Shumë popuj, të tillë si, grekët, hebrejtë, armenët, kinezët janë kthyer në tregtarë të mëdhenj. Këta tregtarë të huaj ndonjëherë ishin politikisht të fuqishëm në vendet ku kishin migruar, por shpesh ishin të dobët të ballafaqoheshin me diskriminim ndaj tyre. Si rezultat, ata mund të bëhen një pasuri e çmuar jo vetëm për vendin e tyre të destinacionit, por gjithashtu dhe shumë e rëndësishme për vendin e tyre të origjinës.

Interesat politike dhe aktivitetet brenda diasporave nuk janë diçka e re. Studimet historike të komuniteteve emigrante tregojnë shkallë të lartë të angazhimit politik të tyre edhe 100 vjet më parë. Përsa e interesave dhe mbështetjes se

diasporës shumë shpesh sjell forma të veçanta të përfaqësimit në qeveri apo ministri të cilat janë të dedikuara për diasporat. Për shembull, një ilustrim interesant mund të jetë shembulli i diasporës kroate në zgjedhjet e vitit 1990. Kroatët jashtë vendit kanë dhënë 4 milionë dollar për fushatën zgjedhore të Fanjo Tuxhmanit, dhe më pas kjo është shpërblyer më përfaqësimin e tyre në parlament, ku 12 nga 120 vende u caktuan për kroatët e diasporës. Kjo shifër e kalon atë e cila u nda për pakicat etnike të Kroacisë.

Qeveritë e shumta tani iu ofrojnë shtetasve të tyre në diasporë llogari të posaçme në valutë të huaj dhe kjo ndihmon për parat e dërguara në shtëpi, gjë që është shumë e kërkuar nga shumë vende (të zhvilluara apo jo), stimuj ose obligacione për investime jashtë vendit, dogana ose nxitje të importit, të drejta të posaçme pronësore ose qasje të privileguara në zona të veçanta ekonomike. Një gjë e tillë duhet të ndodh edhe me qeverinë dhe diasporën e Kosovës. Sa më shumë përkrahje dhe privilegje që i ofrohet diasporës, aq më shumë përfitime do të ketë Kosova si shtet. Mirëpo, për të mbajtur diasporën politikisht të interesuar dhe për të mbështetur rrjedhat financiare, politikanët e emigracionit shpesh përdorin solidaritetin midis shtetasve të tyre. Një gjë e tillë është ilustruar në vitin 1990, kur presidenti irlandez, Mary Robinson shpalli veten udhëheqës të familjes së

zgjeruar irlandeze jashtë vendit.

Edhe Kosova është një shembull i mirë për kontributin që ka dhënë gjatë viteve të '80-ta duke angazhuar aktivist të ndryshëm në Europë si dhe Amerikë, të cilët, fillimisht kanë bërë të njohur problemet të cilat zhvilloheshin në Kosovë. Poashtu duhet të ceket edhe mbështetja financiare që është dërguar gjatë viteve të '90-ta kur popullata shqiptarë ishin të papunësuar. Kjo ndihmë ka qenë e dedikuar në fusha të ndryshme, por është e rëndësishme të përmendet që një investim i madh ka shkuar edhe në fushën e mjekësisë duke bërë të mundur të paktën të shpëtojnë jetën e nxënësve dhe studenteve të cilët kanë qenë të atakuar në mënyra të ndryshme.

Pra, diasporat luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në zhvillimin e ndërtimit të kombit në vendet e varfra dhe ato kanë pësuar transformim të madh, siç janë vendet e Europës Lindore dhe ish-shtet sovjetike.

Një nga programet më të njohura është ajo e "UN Development Program's Transfer of Knowledge through Expatriate Nationals" (TOKTEN) e cila filloi në Turqi në vitet 1970 dhe tani është themeluar edhe nga 50 vende të tjera. Ky program mbështet mijëra shtetas emigrant me ekspertizë profesionale për t'u kthyer në vendet e tyre të origjinës dhe të punojnë për disa javë ose muaj apo edhe të qëndrojnë më gjatë. /Kallxo.com

ÇAJI I RUSIT PO DËRGON SHQIPTARËT E KOSOVËS NË SPITAL

Numri më i madh i pacientëve që kërkojnë trajtim në Kirurgjinë Plastike në QKUK, janë ata me djegie të ndryshme. E djegiet më të mëdha vijnë nga pakujdesia me ibrikët e çajit të zi, ndryshe i njohur si çaji i 'rusit'.

Klinika e Kirurgjisë Plastike në QKUK është e vetmja qendër referente për pacientët kosovarë që kërkojnë ndihmë për trajtimin e djegieve. Në këtë klinikë poashtu trajtohen edhe patologjitë e shuplakës së dorës, lëndime të ndryshme si dhe sëmundje kongjenitale tek fëmijët, shkruan Gazeta Shneta.

Në këtë klinikë bëhet trajtimi i tumorëve benignë dhe malinje në secilën pjesë të trupit. Një projekt që ka filluar në Klinikën e Kirurgjisë Plastike është edhe rekonstruktimi i gjirit pas heqjes tek gratë të cilat kanë karcinoma dhe bëjnë

amputimin e gjirit. Deri më tani janë kryer dy intervenime të tilla.

Në këtë klinikë ka vetëm një sallë operative çka bënë që pacientët të presin deri në një muaj në mungesë të hapësirave për trajtim. Brenda ditës kryhen 4 deri 5 operacione. Gjatë muajit prill janë kryer 145 operacione, ndërsa në ambulanten specialistike janë kryer 680 shërbime.

Mjekja Violeta Zatriqi thotë se në këtë klinikë ka kapacitete të mjaftueshme mjekësore për trajtimin e të gjitha patologjive, por megjithatë ka mungesë të kushteve dhe hapësirave për të kryer shërbimet.

Zatriqi thekson mungesën e një qendre të djegies për të cilën thotë se gjendet pothuajse në çdo shtet. Ajo shton se në këtë qendër do të trajtoheshin ekskluzivisht vetëm pacientët me djegie të cilët

do të kishin dhoma të veçanta me mundësi për pastrim dhe laborator dhe një qendër gjysëmintensive. Për momentin gjysma e klinikës është e improvizuar për këtë shërbim.

"Është shumë në interes të madh sepse një avari apo incident në termocentrale apo dikund tjetër, mund të vijë deri te djegia e një numri të madh të pacientëve dhe ku do t'i trajtojmë ata", deklaroi Zatriqi.

Ajo thotë se pacientët me djegie mbi 40 për qind duhet të trajtohen jashtë vendit dhe për këtë është kosto e lartë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Numri më i madh i pacientëve që kërkojnë ndihmë në këtë klinikë, janë pikërisht nga djegiet. Ato ndodhin zakonisht nga uji i nxehtë, kur fëmijët prekin ose bien në kazanë me ujë të vluar e poash-



tu një numër i madh i pacientëve digjen edhe nga ibrikët e çajit.

"Konsumimi i madh i çajit dhe nga pakujdesia, kemi shumë raste që vijnë me djegie nga ibrikët. Poashtu kemi numër të madh të pacientëve që janë punëtor të KEK-ut të cilët digjen nga rryma dhe në shumë raste kemi edhe amputime sepse janë djegie të thella", deklaroi doktoresha.

Për momentin në këtë klinikë ka filluar edhe shërbimi i mikrokirurgjisë me një ekip prej 4 kirurgëve të cilët janë trajnuar në Irlandë

dhe Suedi. Këta kirurgë bëjnë rriplantimin e gishtit të këputur në aksidente. Ky shërbim për momentin kryhet me anë të metodave me llupa, ndërsa Zatriqi thotë se SH-SKUK iu ka premtuar se do t'i pajisin me mikroskop.

Edhe në këtë klinikë, sikurse në të tjerat ka mungesë të madhe të barnave dhe materialeve shpenzuese. Ndonëse kërkesat janë të vazhdueshme, aty mungojnë medikamentet që nevojiten më së shumti si gazrat apo betadina për pastrimin e lëndimeve.



Patriarkana vulos Autoqefalinë e Kishës ukrainase

Çështja e autoqefalisë së Kishës Ukrainase duke se është e pakthyeshme dhe po hyn në terren politik shtetëror. Mediat raportojnë për një marrëveshje mes Patriarkanës Ekumenike dhe Kievit zyrtar, nënshkruar të shtunën nga Patriarku Vartholomeu dhe presidenti ukrainas, Petro Poroshenko, marrëveshje e cila sanksionon bashkëpunimin dhe koordinimin mes të dyja palëve. "Jam i sigurtë se vendimi për autoqefalinë do të çojë në unitetin dhe unifikimin e të gjithë besimtarëve në Ukrainë", tha Vartholomeu gjatë takimit të zhvilluar në Stamboll.

Vendimi ka provokuar shumë reagime. Një ditë më parë, patriarku i Kishës Ruse, Kirilli foli për një konspiracion kundër ortdhodhoksisë, ndërkohë që mediat ruse kanë përcjellë lajme për peticioni kundër autoqefalisë nga besimtarë ukrainas.



Detaje të reja nga vrasja e Kashoxhit

Mediat turke vazhdojnë të zbulojnë detaje të reja nga vrasja e gazetarit saudit Jamal Khashoggi në konsullatën e Arabisë Saudite në Stamboll.

Një ditë pasi presidenti Rexhep Tayyip Erdogan akuzoi për herë të parë drejtë për së drejti qeverinë saudite për krimin, mediat shkruajnë se dyshohet që pjesë të trupit të gazetarit janë nxjerrë nga konsullata me 5 valixhe. Më pas ato u dërguan në rezidencën e konsullit saudit, ditën e vrasjes më 2 tetor. Mediat raportojnë gjithashtu se janë identifikuar 3 figurat kryesore nga ekipi prej 15 anëtarësh që erdhi nga Arabia Saudite në konsullatë ditën e vrasjes. Njëri prej tyre është Mahir Mutreb, ndihmës i drejtpërdrejtë i princit të kurorës; mes tyre kreu i këshillit shkencor të Arabisë Saudite dhe një kolonel i ushtrisë.

Endërsa trupi i Khashoggi nuk është gjetur ende dhe motivet e vrasjes se tij mbeten ende mister, presidenti Erdogan në një artikull të publikuar në Uashington Post, i bëri thirrje edhe njëherë Rijadit që t'u përgjigjet pyetjeve që kane mbetur pa përgjigje për vrasjen e gazetarit.

LIGJI I RI PËR EMIGRIM NË GJERMANI

KËRCËNIM PËR POPULLSINË NË BALLKAN



Ligji i ri për emigrim, të cilin Gjermania planifikon ta nxjerrë me qëllim për të mbuluar mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, mund të shkaktojë humbje serioze për popullsinë e vendeve të Ballkanit si në Bosnjë e Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë. Ky ligj për emigrim të cilin qytetarët e Ballkanit e shohin si një shpresë, mund të shkaktojë "ikjen e trurit" dhe mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar

Ligji i cili pritet të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2019 dhe që do të lehtësojë punësimin e njerëzve nga shtetet e Ballkanit, po pritet me padurim nga popujt e rajonit ndërkaj një pjesë e madhe nuk është ende në dijeni për rrezikun që mund të ndodhë.

Në një deklaratë nga Ambasada e Gjermanisë në Sarajevë, thuhet se ky ligj ende ndodhet në fazën e përgatitjes dhe se ende është herët për t'i vlerësuar detajet e tij.

"Bosnjë e Hercegovina do të hyjë në rrezik"

Drejtoresha e Unionit të Integritimit në Bosnjë e Hercegovinë, Mirhunisa Zukiç në një prononcim për Anadolu Agency (AA) tha se me hyrjen në fuqi të ligjit për emigracion, BeH do të hyjë në një rrezik të madh. "Do të humbim një numër të madh të njerëzve tanë me profesione të shumta duke filluar nga inxhinieria. Në 5 vitet e fundit rreth 170 mijë persona u larguan nga BeH", tha ajo.

Zukiç thotë se edhe ata të cilët janë kthyer në shtetet e tyre pas luftës në BeH (1992-1995), me këtë ligj të ri do të shkojnë përsëri në shtetet e BE-së, duke filluar nga Gjermania.

Sipas saj, njerëzit në BeH janë të dëshpëruar për shkak të strukturës komplekse politike dhe mos mbajtjes së premtive të dhëna. Zukiç tha se për parandalimin e emigracionit duhet t'i kushtohet rëndësi dhe të dëgjohen problemet, e sidomos të rinjve.

Nga Serbia emigrojnë më së shumti punonjësit e shëndetësisë

Një nga vendet e rajonit që po ballafaqohet me probleme të emigracionit në shtete të BE-së është Serbia. Sipas informa-

cioneve të marra nga Instituti për Punë të Serbisë thuhet se njerëzit nga fusha e shëndetësisë përbëjnë grupin kryesor të cilët emigrojnë nga vendi ndërsa pas punonjësvë të shëndetësisë vijnë shoferët e kamionëve.

Gjatë vitit 2018, 144 persona kanë emigruar dhe janë vendosur në Gjermani ndërsa në qytete të ndryshme të Serbisë, duke filluar nga Beogradi janë organizuar punëtoritë me tema "Jeta dhe Puna në Gjermani".

Miljana Pejiç nga një shoqatë rinore tha se nga Serbia sidomos mjekët dhe infermierët janë të gatshëm që të emigrojnë në Gjermani, duke shtuar se me hyrjen në fuqi të këtij ligji këta persona do të largohen nga Serbia.

Poashtu edhe Tatjana Miliçević e cila po përgatitet të emigrojë në Gjermani tha se i vazhdon studimet master në fushën e teknologjisë dhe se në të njëjtën kohë mëson gjuhën gjermane.

"Kushtet në Gjermani janë shumë të mira. Atyre u duhen ekspertë të fushave të ndryshme. Në të kundërtën me Serbinë, ata respektojnë njerëzit të cilët e zhvillojnë veten", tha ajo.

Nga Kosova dhe Mali i Zi emigrojnë të rinjtë

Edhe në Mal të Zi i cili është shteti më i vogël në Ballkan për nga numri i banorëve, emigrimi në Gjermani është çështje aktuale.

Në një deklaratë nga Ambasada e Gjermanisë në Podgoricë thuhet se në vitin 2017, 876 persona kanë emigruar nga Mali i Zi në Gjermani. Kjo ambasadë njofton se në aplikimet për punë sidomos janë fushat si ndërtimtaria, gastronomia dhe kuj-

desi për të moshuar.

Një nga anëtarët e shoqatës së quajtur "Euromost" (Ura e Evropës) në Mal të Zi, Almer Mekiç thotë se gjatë 3 viteve të fundit rreth 7.000 persona kanë emigruar në shtetet e Evropës, duke bërë të ditur se shumica e emigrantëve janë me diploma universitare.

Sipas të dhënave të Agjencisë për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë për vitin 2017, 5.000 mijë shtetas kosovarë kanë emigruar në Gjermani.

Antigona Ferataj e cila dëshiron të punojë si infermiere në Gjermani tha se nuk ka arritur që të gjejë punë në Kosovë. "Më kanë humbur plotësisht shpresat për të patur sukses në Kosovë. Më ka mbetur edhe një vit për t'i përfunduar studimet. Do të shkoj në Gjermani për të ardhmen e fëmijëve të mi", tha ajo.

Gjendja është kritike edhe në Kroaci

Gjithashtu edhe Kroacia, e cila është anëtare e BE-së, është një nga vendet që po ballafaqohet vazhdimisht me emigrimin. Që nga viti 2013 kur është anëtarësuar në BE, rreth 300 mijë persona kanë emigruar në vendet e BE-së.

Autori i librit "Emigrimi i kroatëve në Gjermani: A po e humbim Kroacinë", Tado Juriç tha se kroatët nuk emigrojnë për shkak të varfërisë, por për shkak të asaj se e ndjejnë veten "të panevojshëm" në vendin e tyre. Ai shtoi se kroatët janë shumë të kënaqur me kushtet jetësore në Gjermani.

Demografi Stjepan Sterc vuri në dukje se në Gjermani jetonë 800 mijë kroatë. Ai theksoi se Gjermania çdo vit humb 90 mijë punëtorë dhe se në këtë aspekt shihet si një destinacion i rëndësishëm për emigrim nga njerëzit e rajonit. (AA)

BRAZILI I JAIR BOLSONAROS

Pavarësisht se Bolsonaro ka mundur të mbështetet tek konsensuset, aspak të fshehura të forcave të armatosura braziliene, sipas analistëve të ndryshëm, ka pak të ngjarë që pushteti ushtarak i vendit do të dëshirojë të hyjë në aventura autoritare, edhe në rastin ku Presidenti i ri dëshiron vërtet ta transformojë nostalgjinë e tij për të kaluarën në një realitet konkret

Duke filluar nga 1 janari 2019, Jair Bolsonaro do të jetë Presidenti i ri i Brazilit. E konfirmojnë rezultatet e balotazhit e së dielës 28 tetor: i shkëputur me mbi 10 pikë përqindje ndaj konkurrentit të tij Fernando Haddad, ish kryebashkiak i San Paolo dhe kandidat "in extremis" i Partisë së Punëtorëve (PT) pas arrestimit të ish Presidentit Lula da Silva, me 55.2% të votave kandidati konservator i ultra të djathtës Bolsonaro, anëtar i Partisë Social-Liberale (PSL), është sot udhëheqësi i demokracisë më të madhe latinoamerikane. Për shumë, një fitore e ditur: ngjitja e tij në majat e politikës braziliene kishte rezultuar evidente qysh në turin e parë elektoral të 7 tetorit, kur i kishte shpartalluar të gjithë kandidatët e tjerë me mbi 46% të votave (kundërt 29% të Haddad), duke munguar për një qime atë mazhorancë absolute që do t'i kishte mundësuar të zgjidhej pa balotazh. Por kush është vërtet ky personazh kaq kontradiktor dhe përçarës? Kujt i detyrohet suksesi i tij elektoral? Cili është Brazili që do të trashëgojë nga paraardhësit e tij? Dhe cilat janë recetat e tij për ta "shpëtuar" vendin nga kriza politike, ekonomike dhe sociale në të cilën dërgjet?

BOLSONARO: "NJERIU I RI" I POLITIKËS BRAZILIANE?

Banori i ri i Palácio do Planalto paraqitet në sipërfaqe si një "outsider" në politikën e Brazilit. Megjithatë, Jair Bolsonaro është anëtar i Kongresit qysh nga viti 1988: një veteran në kuptimin e



KUSH ËSHTË VALLË JAIR BOLSONARO?

Ish kapiten i ushtrisë, parashutist, i diplomuar në Akademinë Ushtarake të Agulhas Negras, Jair Messias Bolsonaro (vitlindja 1955, pinjoll i një familjeje italiane) sapo ka përfunduar mandatin e tij të 7-të si deputet federal i zgjedhur në Shtetin Rio de Janeiro. 30 vitet e karrierës së tij politike kanë parë ta ndryshojë parti 8 herë deri sa ka hyrë në Partido Social Liberal (PSL) nacional - konservatore, i së cilës qe më 2014



deputeti më i votuar i vendit. I konsideruar në vite si një personazh minor, piktoresk dhe thujse folklorik, Bolsonaro ishte i njohur mbi të gjitha për deklaratat e tij kundër grave, homoseksualëve dhe njerëzve me ngjyrë, përbuzjen ndaj pakicave dhe mbështetjen ndaj politikës të dorës së rëndë ndaj kriminelëve dhe liberalizimit të mbajtjes së armëve: pozicione radikale që sot nuk janë zbehur.

vërtetë të fjalës i politikës braziliene, që u ka shpëtuar skandaleve për korrupsion dhe riciklim parashë që në vitet e fundit kanë tronditur institucione, klasë politike dhe kompani publike të vendit, mbi të gjitha gjiganteskun Petrobras. Pikërisht një prej këtyre skandaleve (Operacioni "Lava Jato"), ka çuar më pas në arrestimin e ish Presidentit Lula da Silva. Është përballë një Brazili të zhgënjyer e të zemëruar që Presidenti i ri i së djathtës ekstreme arrin sot të paraqitet si një lider antiestablishment dhe një "njeri i ri" karshi politikës tradicionale, sipas modelit Donald Trump, ndaj të cilit nuk e fsheh vlerësimin dhe admirimin. Nuk është rastësi që, në gjurmët e

"Make America Great Again", midis motive të preferuara nga mbështetësit e tij është pikërisht shprehja në portugezçe: "Faça o Brasil grande outra vez".

Por kush është vallë Jair Bolsonaro? Ish kapiten i ushtrisë, parashutist, i diplomuar në Akademinë Ushtarake të Agulhas Negras, Jair Messias Bolsonaro (vitlindja 1955, pinjoll i një familjeje italiane) sapo ka përfunduar mandatin e tij të 7-të si deputet federal i zgjedhur në Shtetin Rio de Janeiro. 30 vitet e karrierës së tij politike kanë parë ta ndryshojë parti 8 herë deri sa ka hyrë në Partido Social Liberal (PSL) nacional - konservatore, i së cilës qe më 2014 deputeti më i votuar i vendit. I konsideruar në vite si një

personazh minor, piktoresk dhe thujse folklorik, Bolsonaro ishte i njohur mbi të gjitha për deklaratat e tij kundër grave, homoseksualëve dhe njerëzve me ngjyrë, përbuzjen ndaj pakicave dhe mbështetjen ndaj politikës të dorës së rëndë ndaj kriminelëve dhe liberalizimit të mbajtjes së armëve: pozicione radikale që sot nuk janë zbehur dhe që, megjithëse i kanë shtyrë mijëra gra të manifestojnë në qytetet më të rëndësishme braziliene me thirrjen "ele não" (ai jo), duken bile se i kanë siguruar konsensusin e shumicës së elektoratit. Për t'u habitur, pavarësisht se në 30 vite dhe 7 mandate në Kongres ka propozuar rreth 170 projektligje, deri më tani Presidenti i sa-

pozgjedhur brazilian ka arritur që të çojë në votim vetëm 2 prej tyre. Tani mbetet për t'u parë nëse, pas marrjes së postit më të lartë që vendi mund t'i japë, njeriu që ka hyrë në politikë për ta mbrojtur nga shkurtimeve e shpenzimeve ushtrinë nga ku vinte dhe që sot premtonte të sjellë "rend dhe përparim" në një vend të tronditur nga dhuna, korrupsioni dhe nga një rigjallërim shumë i vështirë ekonomik do të arrijë të kalojë nga fjalët tek faktet.

NJË FUSHATË "JOKORREKTE" NË MOMENTIN E DUHUR?

Nga shumë analistë, suksesi i Bolsonaro i atribuohet kryesisht mënyrë së drejtpërdrejtë, për disa primitive dhe brutale, me të cilën gjatë fushatës elektorale ka premtuar për të zgjidhur problemet e mëdha të Brazilit: korrupsionin politik, dhunë kriminale dhe krizën ekonomike. Një strategji komunikimi e fortë dhe kapilare, e karakterizuar nga një thjeshtëzim ekstrem i problematikeve më komplekse të vendit më të madh të Amerikës Latine. Mesazhet e tij janë shpërndarje vetëm në masë minimale nga propaganda e "vjetër" televizive të cilës i kanë besuar shumë prej kandidatëve të tjerë: me vetëm 9 sekonda në ditë kohë televizive në dispozicion, në një vend që është i 3-i në botë për profilet Facebook, neoPresidenti ua ka besuar mesazhet e tij sidomos mediave sociale dhe dhjetëra mijëra mesazheve në WhatsApp (120 milion përdorues në Brazil), praktikisht duke e "përmbytur" me propagandë dhe fake news - shpesh që kishin të bënin me vetë konkurrentët e tij - qytetarët brazilianë.

Qëndrimet ekstremiste e Presidentit të sapozgjedhur janë theksuar pas atentatit të 6 shtatorit ku ka qenë viktimë, gjatë një mitingu elektoral në Shtetin Minas Gerais. Pavarësisht rëndësisë së asaj që ka ndodhur, episodi duket sa ka kontribuar pozitivisht ndaj fushatës së tij elektorale, duke i kursyer shumë përplasje të drejtpërdrejta televizive me kandidatët e tjerë, por që për shkak të pozicioneve dhe deklarimeve të tij shpesh politikisht jokorrektë dhe shokues, e kanë bërë vetë objektin e debateve të tyre. Komunikimi i Bolsonaro ishte i prirur që të bindte, të paktën fillimisht, grupet sociale thelbësore për fitoren e tij: të "djathtës nostalgjike" të cilës i mungon siguria e kohërave të diktaturës ushtarake, të "djathtës evangjeliste" të cilës i janë premtuar të drejta sociale dhe të "djathtës liberale" që prej kohësh lufton kundër anemisë ekonomike të gjigandit luk-



ADMIRIMI PËR TRUMPIN

Është përballë një Brazili të zhgënjyer e të zemëruar që Presidenti i ri i së djathtës ekstreme arrin sot të paraqitet si një lider antiestablishment dhe një "njeri i ri" karshi politikës tradicionale, sipas modelit Donald Trump, ndaj të cilit nuk e fsheh vlerësimin dhe admirimin



sofon. Bashkimi i këtyre 3 grupeve ka përfaqësuar motorin që më pas ka bindur votuesit e shumtë ende të pavendosur. Është e pamohueshme që, njëlloj si Trump, Presidenti i sapozgjedhur brazilian ka ditur të hyjë në lojë në momentin më të përshtatshëm për të: me Lula, rivalin kryesor, në burg dhe jo më i kandidueshëm, një përqindje dhune kriminale shumë të lartë (më shumë se 63000 vrasje në 2017) dhe një elektorat thellësisht të zhgënjyer nga klasa politike (në një sondazh të vitit të kaluar, vetëm 13% e brazilianëve është shprehur e kënaqur me demokracinë e vet), Bolsonaro ka arritur të paraqitet si një alternativë radikale dhe "disiplinuese" ndaj kaosit dhe pasigurisë që gjithnjë e më shumë duket se frustron qytetarët brazilianë.

BRAZILI, NJË GJIGAND AKOMA NË KRIZË?

Brazili po e rimerr veten me ngadalë nga reçioni më i rëndë ekonomik i historisë së tij: midis viteve 2015 e 2017, PBB-ja është rrudhur me rreth 7%. Megjithatë, rigjallërimi ekziston dhe kriteret makroekonomikë të vendit duken të mira: Brazili është ekonomia e 8-të e botës (2000 miliard në terma të PBB-së), inflacioni është kthyer në nivele të përmbajtura (3.7%, pas 9% vjetor të 2015 dhe 2016) dhe koeficienti i rritjes ekonomike është kthyer në pozitiv (1.4%).

Nga pikëpamja makroekonomike, pika e dobët është në fakt financën publike. Në fakt, Bolsonaro do t'i duhet të përballë me menaxhimin e një vendi me deficit bilanci ende shumë të lartë (afër -9% të PBB-së) dhe një borxh që në 3 vitet e fundit është rritur në mënyrë shqetësuese me rreth 20% në raport me PBB-në, duke arritur të tejkalojë 80% të PBB-së.

Bolsonaro ka njoftuar tashmë se ka ndërmend që ta sjellë balancin në barazim sa më shpejt që të jetë e mundur. Si? Kryesisht me shkurtime të shpenzimeve publike. Por do të jenë të nevojshëm shkurtime të mëtejshme dhe shumë më të rënda të shpenzimeve publike në rast se Presidenti i sapozgjedhur do të donte të mbante premtimin elektorale uljes së taksave. Ndoshta shkurti-

met e shpenzimeve mund të vijnë edhe nga privatizimi i sektorëve të gjerë ekonomikë të Brazilit sot - tërësisht apo pjesërisht - në duart e shtetit. Një recetë neoliberaliste e mbështetur nga Paolo Guedes, këshilltari i tij ekonomik.

Domosdoshmëria për të adoptuar një politikë "rreptësie financiare" në periudhë afatshkurtë paraqet gjithsesi jo pak rreziqe, sidomos në një vend ku pabarazia mbetet në një nivel ndër më të lartit në botë. Shkurtime të domosdoshme e shpenzimeve publike nuk ka sesi mos të godasin politikën më të kushtueshme, që përfshijnë natyrisht masat e welfaresi pensionet, shëndetësia publike dhe subvencionet e papunësisë, që mbetet shumë e lartë dhe llogaritet në rreth 13%.

ÇFARË DO TË BËJË BOLSONARO?

Siç e shpjegon në komentin e tij Anthony Pereira (King's College Brazil Institute), Bolsonaro përfaqëson ngritjen e një të djathtë ideologjike e ndryshme nga ajo "pragmatiste" dhe "padronale" që deri në këto zgjedhje dukej se karakterizonte partitë e djathta që konkurronin në zgjedhjet presidenciale. Kurse Bolsonaro e vë theksin mbi Zotin dhe Kristianizmin evangjelist, patriarkatin dhe familjen tradicionale, lirinë e mbajtjes së armëve, pronën private dhe liberizmin ekonomik. "Vdekje banditëve", "më shumë siguri për të gjithë", "burg për të korruptuarit", "armë të gjithë brazi-

lianëve për t'u mbrojtur nga kriminelët", "të luftojmë që Brazili të mos përfundojë si Venezuela" janë premtime me të cilat Bolsonaro dëshiron të shërojë një Brazil të zhgënjyer nga klasa politike, gjithnjë e më shumë i dhunshëm dhe akoma i plagosur nga recisioni ekonomik. Nëqoftëse detajet e recetave ekonomike me të cilat Bolsonaro propozon që t'ia dalë privatizime, ulje taksash dhe shpenzimesh publike, liberalizimi, reformë të pensioneve, krijimi i një superMinistrie të Ekonomisë - duken për momentin mjaft të vullgullta (dhe, të paktën në parim, nuk janë krejtësisht tërheqëse për investitorë dhe tregje, që sot presin shumë nga fitorja e tij), ajo që preokupon shumë vëzhgues është perspektiva sesi Presidenti i ri do të kërkojë të shndërrojë në realitet idetë e tij lidhur me sigurinë, arsimin, mjedisin dhe të drejtat civile. Për shembull, për të përballuar plagën e kriminalitetit dhe të dhunës, Bolsonaro propozon uljen e moshës së përgjegjësive penale nga 18 në 16 vjeç dhe një modifikim të ligjit për armëmbajtjen, që ta lehtësojë shumë posedimin e saj; iniciativa që do të duhej t'u shtoheshin një tutelë juridike më e madhe e forcave të rendit e prirur që t'i favorizonte diskrecionalitetin. "Asnjë nuk do të donte që një polic të vriste", ka shpjeguar në një intervistë për revistën "Time", "por unë dua t'u jap një kartabiankë për të mos vdekur". I mbështetur nga e djathta kristiane evangjelistë braziliane, më 11 tetor Bolsonaro ka

firmosur një marrëveshje me një shoqatë votuesish katolikë, ku ka premtuar "të mbrojë kuptimin e vërtetë të martesës si lidhje midis burrit dhe gruas" dhe të "luftojë ideologjinë gender", duke filluar nga programet shkollorë. Janë me sazhe të qartë - nga ana e një konservatori që, përveçse nuk e fsheh përbuzjen e tij për gjininë femërore, nuk ka munguar që ta krahasojë homoseksualitetin me pedofilinë - që shpejt mund të transformohen në iniciativë legjislative kundër financimeve ndaj programeve antidhunë për gratë dhe komunitetet LGBTQ. Edhe pakicat dhe mjedisi duket se janë në shënjestrën e Presidentit të ri: për shembull, në shumë raste ka shpërthyer kundër politikave të mbështetjes dhe kuotave të rezervuara për grupet sociale më pak të përkrahur dhe pakicave. Së fundi, i mbështetur edhe nga lobi i fuqishëm i prodhuesve bujqësorë brazilianë, Presidenti ka kërcënuar lehtësimin e ligjeve mbi shpyllëzimet dhe të ndjekë Donald Trump në tërheqjen nga Marrëveshja e Parisit për Klimën, përveçse për ta ritrajtuar pak ditë më parë në shkëmbim të sigurimeve lidhur me sovranitetin e plotë të Brazilit mbi "Tripla A", një territor me rëndësi themelore mjedisore për planetin i shtrire nga Andet, në Pyllin Amazonas, në Atlantik.

PAS VOTIMIT: RREZIK AUTORITAR?

Nostalgjik i deklaruar i diktaturës ushtarake që ka qeverisur

Brazilin nga viti 1964 deri më 1985, Bolsonaro nuk ka lënë rast pa deklaruar publikisht admirimin e tij për liderë të tjerë autoritarë (së fundmi Presidentin filipinas Rodrigo Duterte). Në të kaluarën, Bolsonaro është shtyrë deri aty sa ka premtuar që, në rast se bëhej ndonjëherë President, do ta vinte vendin në kontrollin e ushtarakëve qysh nga "dita e parë". Fushata e tij elektorale është mbështetur aktivisht nga figura të ndryshme kryesore të forcave të armatosura braziliane dhe pak vite më parë zëvendësi i tij, gjenerali në pension Antônio Hamilton Martins Mourão, ka pohuar se në rast se pushteti gjyqësor nuk do të ishte në gjendje që të vinte rend në kaosin politik të vendit, atëherë një gjë e tillë do të imponohej nga ushtria nëpërmjet një ndërhyrjeje ushtarake. Kështu që janë shumë ata që frikësohen se me fitoren e Bolsonaro Brazili vërtet rrezikon që të kthehet në kohën e diktaturës.

Megjithatë, siç shpjegon Loris Zanatta (Universitë di Bologna), përtej proklamimeve plot efekt, ka mundësi që ngarkesa subversive e Jair Boslonari pjesërisht të përthithet si nga problemet e mëdha strukturore të vendit të cilat Presidenti do të duhet t'i luftojë me masa konkrete, ashtu edhe nga vetë sistemi politik e institucional brazilian. Nga njëra anë, vetë struktura e Kongresit Kombëtar të Brazilit, ku Bolsonaro nuk do të ketë një shumicë absolute, kërkon në fakt që të krijohen aleanca të gjera e transversale dhe, sidomos për reformat e mëdha, të hyhet në kompromise me forcat e tjera politike. Nga ana tjetër, sistemi gjyqësor brazilian dhe Gjykata Supreme e vendit, të paktën për momentin, ruajnë një shkallë të lartë autonomie. Së fundi, pavarësisht se Bolsonaro ka mundur të mbështetet tek konsensuset, aspak të fshehura të forcave të armatosura braziliane, sipas analizave të ndryshme, ka pak të ngjarë që pushteti ushtarak i vendit do të dëshirojë të hyjë në aventura autoritare, edhe në rastin ku Presidenti i ri dëshiron vërtet ta transformojë nostalgjinë e tij për të kaluarën në një realitet konkret. (bota.al)





KOMUNA E SARAJIT

KORIGJIM I SHPALLJES nr. 3/2018

për tjetërsim të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë të ankandit publik elektronik në Komunën e Sarajit

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lënda e ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronësi e Republikës së Maqedonisë, e paraparë me DOKUMENTACION LOKAL TË PLANIT URBANISTIK PËR NDËRTIMIN E KOMPLEKSIT PRODHUES NË PJESËN E PK 10711/2 PIJES NGA PK 10712 PIJES NGA PK 13618 DHE 10711/7, V.Q. LLAKI, K.K. SARAJ – SHKUP.

Duke vepruar në pajtim me nenin 52 paragrafi 3 nga Ligji për tokë ndërtimore (Gazeta zyrtare e RM nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16), a në bazë të nenit 56 paragrafi 3 nga i njëjti Ligj, Komisioni kryen korrigjimin e shpalljes në pjesën e:

AFATET PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 19.11.2018, në formë elektronike në adresë vijuese: www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik do të mbahet në formë elektronike në faqen vijuese të internetit www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik për PN1 do të fillon më 21.11.2018, në ora 09:30, dhe e njëjta nuk mundet të zgjasë më pak se 15 minuta.

Ankandi publik për çdo parcelë ndërtimore nga rishikimi i njëanshëm tabelorë, vazhdohe për 2 minuta deri atëherë kur në 2 minutat e fundit nga ankandi ka ofertë të re.

Një ofertues mund të jetë pjesëmarrës me ofertë në një ose më shumë parcela, ose në të gjitha parcelat nga shpallja.

[Kjo shpallje do të jetë e publikuar edhe në WEB faqen e Komunës së Sarajit ww.sara.gov.mk](http://www.sara.gov.mk)

Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik të tokës

Ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë

Komuna e Sarajit



KOMUNA E SARAJIT

KORIGJIM I SHPALLJES nr .4/2018

për tjetërsim të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë të ankandit publik elektronik në Komunën e Sarajit

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lënda e ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronësi e Republikës së Maqedonisë, e paraparë me DOKUMENTACION TË PLANIT LOKAL URBANISTIK për pjesë nga PK 10466, PIJES NGA PK 10468, pjesë nga 10469, pjesë nga PK 10470, PK 10471, PK 10472 dhe pjesë nga PK 10473/1, me dedikim: Industria e lehtë (G2) me objekte përcjellëse – Prodhimtari të mjeteve për industri ekologjike KK Saraj Komuna e Sarajit

Duke vepruar në pajtim me nenin 52 paragrafi 3 nga Ligji për tokë ndërtimore (Gazeta zyrtare e RM nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16), a në bazë të nenit 56 paragrafi 3 nga i njëjti Ligj, Komisioni kryen korrigjimin e shpalljes në pjesën e:

AFATET PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 19.11.2018, në formë elektronike në adresë vijuese: www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik do të mbahet në formë elektronike në faqen vijuese të internetit www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik për PN1 do të fillon më 21.11.2018, në ora 11:30 dhe e njëjta nuk mundet të zgjasë më pak se 15 minuta.

Ankandi publik për çdo parcelë ndërtimore nga rishikimi i njëanshëm tabelorë, vazhdohe për 2 minuta deri atëherë kur në 2 minutat e fundit nga ankandi ka ofertë të re.

Një ofertues mund të jetë pjesëmarrës me ofertë në një ose më shumë parcela, ose në të gjitha parcelat nga shpallja.

[Kjo shpallje do të jetë e publikuar edhe në WEB faqen e Komunës së Sarajit ww.sara.gov.mk](http://www.sara.gov.mk)

Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik të tokës

Ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë

Komuna e Sarajit



KËRKESË

Për zgjedhjen e ofertave Nr. MIMO.R. 05/18, MIMO.R. 06/18 dhe MIMO.R. 07/18

Projekti i integritit ndërtimor i USAID-it për të rinjtë në arsim, i implementuar nga qendra Maqedonase për edukimin qytetar (QMEQ) bën thirrje të të gjithë firmat kualifikuese dhe licencuese për punimet e ndërtimit dhe instalime mekanike, ndërsa janë të regjistruar dhe punojnë në Republikën e Maqedonisë, të parashtrajnë oferta për projektet: **MIMO.R. 05/18 - "Vendosja e dritareve të reja" në shkollën fillore "Kiril dhe Metodij"- f. Rramanli, komuna e Kumanovës, MIMO.R. 06/18 - "Vendosja e dritareve të reja" në shkollën e mesme komunale "Pero Nakov" - komuna e Kumanovës dhe MIMO.R. 07/18 - "Rikonstruksioni i lidhjes së nxehtë për sallën sportive dhe vendosja e dyerve të reja në klasat" në shkollën fillore "Aco Shopov" në lagjen Radishan, komuna e Butelit.** Palët e interesuara mund të kërkojnë kopje të dokumentacionit të tenderit duke filluar nga data 5 Nëntor 2018 në hapësirat e Projektit në rrugën Vasil Gjorgjov 16, kati 2 (Qendra Zebra) në Shkup. Telefon për informata: 070/225 323 (nga 08:30 deri 16:30). Të gjitha ofertat duhet të parashtrohen jo më vonë se 19 Nëntor 2018, deri në orën 14:00 në adresën e theksuar më lartë.

Vërejtje: Përzgjedhja e ofertave për kërkesat e përmendura më lartë nuk do të thotë përcaktim automatik për kontratë pune.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (G. zyrtare e RM nr. 74/15, tekst i rishikuar) SHF „Çajla“ f.Çajlë - Gostivar shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të punës me kohë të caktuar deri më 31.08.2019

1. Dy mësimdhënës të gjuhës maqedone, njëri me orar të plotë dhe tjetri me 8 orë.
2. Një mësimdhënës për matematikë, 14 orë.
3. Një mësimdhënës për fizikë dhe inovacione, 10 orë. (deri në kthim të drejtorit)
4. Një mësimdhënës për gjuhë angleze, 21 orë.
5. Një mësimdhënës për informatikë, 6 orë.
6. Një mësimdhënës për gjuhë gjermane, 16 orë.
7. Një mësimdhënës për gjuhë shqipe, 20 orë.

Orari i punës për kuadrin mësimor është në varësi prej orarit mësimor.

Paga bazë e arsimtarit është 20 644 den.

Kandidatët përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parapara në Ligjin për arsim fillor.

Me **Lutjen** kandidatët të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- **Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës.(e vërtetuar në noter)**

- **Certifikatë të shtetësisë (e vërtetuar në noter)**

Shpallja zgjatë **5 (pesë)** ditë pune prej ditës së shpalljes. Dokumentet të dorëzohen në adresën: **SHF „Çajla“ Çajlë p.n. - Gostivar. Kontakt tel: 075339972.**

SHF „Çajla“ Çajlë – Gostivar

SH.F.K. "Ismail Qemali" në Gostivar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune shpall:

KONKURS

Shkolla fillore qendrore

Për mësim në gjuhën shqipe

1. Dy mësimdhënës për gjuhë gjermane deri më 31.08.2019
2. Një mësimdhënës i etikës së religjioneve deri më 31.08.2019
3. Një mësimdhënës për informatikë deri më 31.08.2019
4. Një mësimdhënës për fizikë deri më 31.08.2019
5. Një mësimdhënës për arsim fizik dhe shëndetësor deri më 31.08.2019
6. Një mësimdhënës për inovacione për 9 orë mësimore deri më 31.08.2019
7. Një mësimdhënës i grupit klasor në paralele me nxënës me nevojë të veçanta deri më 31.08.2019
8. Një mësimdhënës i gjeografisë deri më 31.08.2019
9. Një mësimdhënës i arsimin figurativ deri në kthimin e arsimtarës nga pushimi i lehonisë.
10. Një mësimdhënës i grupit klasor deri në kthimin e arsimtarit nga funksioni.
11. Një mësimdhënës i arsimin fizik dhe shëndetësor deri në kthimin e arsimtarit nga funksioni.

Për mësim në gjuhën turke

1. Një mësimdhënës i grupit klasor deri në kthimin e arsimtarës nga pushimi i lehonisë.

Shkolla periferike në fshatin Simnicë me mësim në gjuhën shqipe

1. Një mësimdhënës për Matematikë-Fizikë deri më 31.08.2019

Rroga neto do të jetë 21.700,00 den.

Orari i punës prej 7.00-15.00.

Lutjet dorëzohen në Shk. „Ismail Qemali“, Gostivar

Lutjes i bashkëngjiten edhe dokumentet plotësuese në bazë të Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjit për arsimin fillor.

Konkursi është i hapur 5 ditë nga dita e shpalljes.

Numri i prot. 0401-473

02.11. 2018

SH.F.K. "ISMAIL QEMALI" GOSTIVAR

Në bazë të nenit 175, paragrafi 1 nga Ligji për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 82/2018) dhe vendimit për shpalljen e konkursit të bërë në seancën e Këshillit mësimor-shkencor e mbajtur më 02.11.2018, dekani i Fakultetit Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup pranë Universitetit "Shën Kiril dhe Metodij" në Shkup, shpall:

KONKURS

- Për zgjedhje të mësimdhënës të të gjitha titujt mësimor-shkencor në fushën shkencore

shkencë politike teorike për një periudhë prej 5 (pesë) vite _____ (1)

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parapara në Ligjin për arsim të lartë dhe aktet e përgjithshme të Universitetit dhe Fakultetit.

Në bashkëngjitje me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të parashtrajnë edhe: dëshmi, përkatësisht vendim, dhe/ose certifikatë, dhe/ose diplomë për shkallen adekuate të fituar në edukim - doktor i shkencave, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, certifikatë për shtetësi, biografi e shkurtë (CV), listë e punimeve shkencore dhe profesionale të publikuara dhe nga një kopje të punimeve.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në pëlqim me Ligjin për arsim të lartë dhe aktet e përgjithshme të Universitetit dhe Fakultetit.

Orari i punës për mësimdhënës është i përcaktuar në pëlqim me aktet e Fakultetit.

Dokumentet parashtrohen në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, bul. "Goce Delçev" nr. 96 - Shkup, në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit.

Informata shtesë në tel: 02/3117-244

Fakulteti Juridik „Justiniani i Parë“ në Shkup



Nga Ismail ARSLANI

SHEH MUSTAFË TETOVA, STRATEGU I LIDHJES SË PRIZRENIT

Në gjurmë pas kolosit shqiptar, strategut dhe njeriut të dytë (nënkryetarit) të Lidhjes së Prizrenit (1878), Sheh Mustafë Tetova (1800-1893), do të gjejmë pasardhës edhe sot në Tetovë, të cilët vetëm që kanë dëgjuar se një stërgjysh i tyre kishte punuar me shumë sakrificë për çështjen kombëtare shqiptare. Suat Ramadani, pensionist nga Tetova, kujtohet për rrëfimet e nënës së tij, znj. Saime, e cila derisa ishte gjallë /2005/, me pietet fliste për stërgjyshin, i cili e kishte vendosur në Tetovë familjen e shpërngulur nga Fllorina e Çamërisë, në gjysmën e parë të shekullit XIX. Ky flet për Sheh Mustafë Tetovën si për një personalitet që shquhet për nga aftësitë e tij diplomatike, në një kohë shumë të vështirë për popullin shqiptar, kur trojet e shqiptarëve po copëtoheshin nga Fuqitë e Mëdha.

Stërnipi që mban emrin e Sheh Mustafës, i cili jetonte me familje në një lagje të Çarshisë së Epërme të Tetovës, asokohe (2006), kur bëmë një takim të shkurtër me të, ishte në moshë të shtyrë (80 vjeç) dhe i dobët me shëndet, u shpreh me keqardhje se asnjë dokument dhe as ndonjë fotografi nuk ka mbetur nga Sheh Mustafë Tetova, nga frika se mos i zbulonte regjimi komunist gjatë viteve të vështira dhe bastisjeve të shpeshta, kërcënimeve të vazhdueshme, represioneve ndaj atyre që ruanin kujtimet ose, edhe më keq, dokumentet për personalitetet e shquara kombëtare shqiptare, ndaj dhe ato një kohë janë fshehur, ndërsa më vonë edhe janë tretur diku pa gjurmë.

KU TRETË BIBLIOTEKA E PASUR E SHEH MUSTAFËS

Sheh Mustafa ka pasur në shtëpinë e tij në Tetovë një bibliotekë shumë të pasur të librave, që vështirë se i gjeje diku, të shumtën me shkrim osman /turqishte e vjetër/, me vlerë të lartë letrare, shkencore, historike e fetare, të cilat gjatë shumë vitesh ishin shkapërderdhur dhe grabitur nga persona që nuk i dimë as sot e kësaj dite, shprehej me dëshpërim, stërnipi i këtij atdhetari, plaku Mustafa. Sipas Sabri Mustafës, djali më të madh të Sheh Mustafës, Ruhi Nakshibendi, si quhej ndryshe shehu, kishte qenë nga fundi i jetës udhëheqës i një Teqeje në veriperëndim të Tetovës, që mund të shihet nga vula e shehut Mustafë në Teqenë Nakshibendi. Djali më i vogël i Sheh Mustafës ishte Hysni, i cili kishte qenë shehu i fundit i këtij tarikati në këtë teqe.

Sipas disa të dhënave biografike turke, Sheh Mustafë Tetova, ishte i lindur në ishullin Gykçe

Sheh Mustafë Tetova, ishte i lindur në ishullin Gykçe (Gökçeada) të Egjeut (Imbros). Qysh si i ri ishte zhvendosur në qytetin e Kallkandelenit (Tetovë), i cili në atë kohë, i përkiste Vilajetit të Kosovës. Ai ishte njëri nga pjesëmarrësit e Lidhjes së Prizrenit, që krijoi bazat e nacionalizmit shqiptar dhe ky u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes

(Gökçeada) të Egjeut (Imbros). Qysh si i ri ishte zhvendosur në qytetin e Kallkandelenit (Tetovë), i cili në atë kohë, i përkiste Vilajetit të Kosovës. Ai ishte njëri nga pjesëmarrësit e Lidhjes së Prizrenit, që krijoi bazat e nacionalizmit shqiptar dhe ky u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes. Në Tetovë jetoi deri në vitin 1881, kur me familje u shpërngul në Stamboll. Në vitin 1893, kur ndërrohet jetë, varrosët në oborin e mauzoleut "Jahja Efendi" (Yahya Efendi), në parkun e Pallatit Jëlldëz (Yıldız) të Stambollit.

XHELAL HUSNIU PËR PRANGOSJEN E SHEH MUSTAFËS NGA SULLTANI

Pas gjurmëve të Sheh Mustafë Tetovës, nënkryetarit e Lidhjes së Prizrenit, takojmë në Tetovë Xhelal Husniun, pinjollin e këtij personaliteti të shquar kombëtar, i cili ka marrë për mbiemër emrin e më të voglit prej dy djemve të Sheh Mustafës, atë të Husniut. Xhelali, stërnip pas shumë brezash i Sheh Mustafës, tjerë me ngadalë rrëfimet e babait të tij, Mustafës, që i mbajti në kujtesë ndër vite ndodhitë për jetën dhe veprimtarinë e Sheh Mu-



• Xhelal Husni, pinjoll i familjes së Sheh Mustafës



stafës, emrin e të cilit mbante Mustafa i riu. Stërnipin, Xhelalin, sikur po e ndjek një instinkt për të zbuluar sa më shumë detaje për stërgjyshin e tij, duke gjurmuar nëpër arkiva në relacionin Prizren-Stamboll.

Prej tij dëgjojmë për herë të parë për emrin e babait të Sheh Mustafës (1800-1893), që quhej Sheh Numan Efendi, i cili merr familjen e tij, duke qenë Sheh Mustafa në moshën rinore, për t'u shpërngulur nga Fllorina e Çamërisë për në Tetovë, diku në dekadat e para të shekullit 19. Sipas tij, Sheh Mustafa ka pasur dy djem: Sabriun dhe Husniun. Husni ka pasur 3 djem: Hajriun, Abdylhalimin dhe Ibrahimuratin (ky i fundit nuk ka lënë trashëgimtar).

Sipas rrëfimeve të Hajri Efendiut, që i ka mbajtur në kujtesë stërnipi Mustafa, të cilat i ka përcjellë të birit të vet, Xhelalit, thuhet se në vitet e mbajtjes së Lidhjes së Prizrenit, për veprimtarinë e ngjeshur politike të Sheh Mustafë Tetovës, përhapet opinioni se ky punuaka kundër interesave të Perandorisë osmane, ndaj dhe një ditë ushtarët e kësaj perandorie prangosin Sheh Mu-

stafën në Tetovë dhe në pranga e dorëzojnë te Sulltan Abdylhamiti II në Stamboll. Sulltani e merr në pyetje dhe nga biseda që zhvillon me Sheh Mustafën, vëren që ky kishte qenë me një kapacitet mjaft mirë të ngjeshur intelektual, ndaj dhe i propozon që të mbetet pranë tij në Stamboll, si vezir i tij personal. "Haram më qoftë dita kur t'i kanë vënë ushtarët e mi këto pranga në duar e këmbë. Hidhi prangat dhe eja pranë meje të punosh si këshilltar!", kishte thënë Sulltani.

Sheh Mustafë Tetova nuk pranon menjëherë ofertën për të qenë vezir i Sulltanit, me arsyetimin se kishte do punë të pakryera në Prizren dhe se ishte i detyruar që të kthehet. Sulltani lejon që të shkojë i lirë. Pas një kohe kthehet (1881) në Stamboll dhe aty mbetet deri në fund të jetës së tij.

Sheh Mustafa kishte lënë një pasuri të patundshme në Stamboll. Në gjysmën e parë të shekullit 20-të, nipi i tij, Abdylhalimi shkon në Stamboll, ndërsa vëllai i tij, Hajri Efendi, po ashtu, në vitin 1937, bashkë me familjen shpërngulen nga Tetova për në Stamboll, ku priten mjaft mirë

dhe gëzojnë shumë privilegje. Familja ishte vendosur në do pallate bregdetare, në rrugën "Sutlice sok." nr. 8, në lagjen Balikeser të Stambollit. Hajri Efendi, i cili ka qenë hoxhë, sikundër babai i tij Husni, i biri i Sheh Mustafës, të cilët kanë nxjerrë shumë nxënës (talebe), përkundër jetës luksoze në Stamboll, nuk ka mundur të qëndrojë më gjatë kohë dhe pas 5 vjet qëndrimi në mërgim, vendos të kthehet në Tetovë me familjen në vitin 1942, për të vazhduar misionin e vet arsimues. Shumë ulla të Tetovës dhe të Vilajetit të Kosovës kanë dalë nga duart e Husni ef. dhe Hajri efendiut.

DITARI I PABOTUAR 500 FAQESH I SHEH MUSTAFËS

Në bisedë me Xhelal Husniun, mësojmë se Sheh Mustafa jo vetëm që ka pasur një bibliotekë të pasur me libra me shumë vlerë, por edhe vetë ka shkruar dhe ka botuar libra. Sipas tij, është mjaft me vlerë libri i pakryer, i titulluar "Ditari" apo "Kronika", të cilin ai e ka shkruar në vazhdimësi gjatë jetës, duke shënuar ngjarjet më të rëndësishme të kohës. Libri është shkruar në osmanishte (turqishten e vjetër) dhe është në pronë të trashëgimtarëve të sotëm në Tetovë. Xhelali thotë se ky libër prej afër 500 faqesh ka mbetur i pakryer, sepse pas shkrimeve të fundit kanë mbetur edhe shumë faqe të pashkruara.

Shumë libra nga biblioteka personale e Sheh Mustafës janë dorëzuar për ruajtje në Xhaminë e Madhe të Çarshisë së Epërme të Tetovës, sikundër edhe disa relikte fetare, si dhe një orë muri që ende ekziston. Në vitet e 30-ta të shekullit të kaluar, në shtëpinë e familjes Mustafa, pas disa gjermimeve, është gjetur statuja miniaturale ilire nga periudha e p.e.s., e cila është sekuestruar nga shteti, e njohur si "Menada tetovare", figura e së cilës është vendosur në bankënotën 5 mijë denarësh.



Mendo
SIGURI
PA KUFI.

Mendo



+389 2 3288 800
www.uniqa.mk

SIGURIME
JETË dhe JO-JETË

DASHI 21. mars - 20. prill
Pasi keni zgjidhur të gjithë detyrimet profesionale, mundohuni që të përqendrohni më shumë tek disa projekte me të cilat po merreni prej kohësh. Kjo ditë ju sheh më të pavarur në çështjet e biznesit.

DEMI 21. prill - 21. maj
Kjo është një ditë interesante nga pikëpamja ndjenjave, ku parashikohen njohje të reja dhe mundësi të shumta për të zyrarizuar një raport. Duhet të jeni më romantik.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Shmangni marrjen përsipër të rreziqeve shumë të mëdha lidhur me situatën tuaj ekonomike. Kjo pasi nga pikëpamja profesionale do të keni nevojë për të marrë më shumë konfirmime para se të nisni një projekt të ri. Duhet të jeni gati për të kërkuar kompromis lidhur me strategji të reja.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Kjo është një fundjavë e mirë për të pushuar dhe për tu shkëputur nga ngarkesa e punës. Megjithatë duhet të jeni më të qartë dhe më të vendosur në mënyrën tuaj të shprehurit, sidomos nëse jeni në kërkim të më shumë vëmendje nga ana e partnerit/es tuaj.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Nga pikëpamja sentimentale ky është një moment i mirë për të shprehur hapur ndjenjat tuaja, për shkak se gjatë ditëve të fundit keni pasur keqkuptime me partnerin/en. Horoskopi i kësaj dite parashikon marrjen e përgjigjeve të rëndësishme.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Do të ndiheni të vënë në provë, për shkak se jeni duke nisur një rrugëtim të ri profesional, mjaft të rëndësishëm për karrierën tuaj aktuale. Mos u dorëzoni para pengesave të para, pasi do të dini që të zgjidhni çdo problem.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Ky është një moment shumë i mirë për të nisur të planifikoni një shëtitje apo një udhëtim romantik, i cili do ju lejojë që të rigjeni harmoninë me partnerin/en. Në dashuri do të jeni më të fortë dhe më joshës, ndaj jini gati për të bërë për vete persona të rinj.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Mbrëmje interesante për ta kaluar me familjen ose me miqtë tuaj, por edhe për të rikuperuar kohën e munguar, për shkak të punës së tepërt. Do të jeni të lodhur, por kjo gjë nuk do ju pengojë që të gjeni qetësinë për të cilën keni nevojë. Ky është një moment shumë i mirë, për të eksperimentuar në vendin e punës.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Do të keni nevojë për të parë disa problematika nga një këndvështrim tjetër dhe për këtë arsye, do të keni nevojë për mbështetjen e bashkëpunëtorëve tuaj, shkruan noa.al. Këshillohet që gjatë kësaj dite të bëni kujdes me shëndetin.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Mund të shijoni një surprizë të këndshme, e cila do ju bëj mjaft euforik dhe emotiv. Parashikohet një ditë e bukur, për tu kaluar me familjet. Mjaft të favorshme janë çështjet e biznesit dhe negociatat e reja.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Mundohuni që ti kategorizoni më mirë angazhimet tuaj, pasi do ju duhet të hiqni dorë nga disa prej tyre, në mënyrë që të rigjeni energjinë e humbur. Lodhja mund t'iu shpërqendrojë, ndaj kjo është periudha ideale për të pushuar më shumë.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Duhet të përqendrohni maksimalisht lidhur me disa projekte që parashikohen të jenë të frytshme. Mundohuni të jeni më të kuptueshëm dhe të gatshëm ndaj nevojave të bashkëpunëtorëve, pasi në të kundërt rrezikoni që të çoni dëm gjithë mundin.

	7			2			1	
			4	5	9			
6								2
	5		7				4	
7	9						6	3
	8				4		5	
3								5
			5	3	2			
	2			1			7	

PËRKUJTIM



SEXHEDIN KASAMI
1952 - 2018

Ndarja nga jeta e mësuesit Sexhedin Kasami na pikëlloi të gjithëve. Përcjellja në botën e tij të amshuar, pa disa fjalë të shkruara dhe publikuara do të ishte e zbehtë. Sepse, tërë jetën ia kushtoi arsimit, për shkrim dhe lexim. Tri dekada punoi me nxënës, ku vu themelet e para ndër gjeneratat që vijnë pas. Ndërsa pjesën tjetër të punës e kaloi si Zëvendësudrejtor në shkollën e fshatit. Kur shkante në punë me shpirt e zemër të trazuar, shpesh e përsëriste "këto të rinjtë, nuk na pyesin, as s'na respektojnë"!.. Tiparet e tija si njeri e mësues, ishin shumë korrekte. Për veprën dhe biografinë, fliste kortezhi i gjatë i pjesëmarrësve në varganin mortar. Ai me shembullin tipik të mësuesit dhe edukatorit, do të kujtohet gjatë nga gjeneratat e reja, fshatarët, shokët dhe familjarët. Ndaj, prehu në qetësi dhe të qoftë toka e lehtë.

E përkujton Hasan Hoda.

Mensur Mamuti	FILM ME AKTOREN NË FOTO KENGËTARJA ITALIANE, RAFAELA	H	SEKRETARI I MAHATMA GANDIT, MORARXHI AKTORJA AMERIKANE NË FOTO	D	ISHULL NË ISLANDË
NË KËTË ANË, KËNDEJ					
SHTËPIA E BANIMIT					
B					
AKTOR AMERIKAN, O NIL, IATI I AKTORES NË FOTO					
KAPËRCIM					
K					
REPARTI USHTARAK				ANGSTREMI	
DISENJATORI FRËNG I MODËS, KRISTIAN				NDAJFOLJE, NEPËRARA, ARAVE	
HENDBOLLISTE DANEZE-KOSOVARE, LEONORA					
QË ËSHTË ME VUA					
V					
S					
LUMË NË FRANCË					PRIJËSI I EGJIPTIT TË LASHTË
PRIJËSI I IMAMËVE, UL-ULEMA					PERËNDIA E DIELLIT TË EGJIPTASIT TË LASHTË
					NJËSI PËR MATJEN E ARIT
					EFEKT I DRIDHJES SË ZERIT NË MUZIKË
					ENVER IDRIZI
					FSHAT NË ZELENIKOVË, AFËR SHKUPIT
KOHA	TEODOR LAÇO			DËSHMITË	
PJESA E ÇATISË KU RRJEDH SHIU				STANAR, ÇELNIK	
STRONCIUMI			EMRI I LASHTË I RAJONIT TË IZRAELIT DHE PALESTINËS		
			ALEKSANDËR XHUVANI		
QË I PËRKËT TEATRIT, TEATRILE					OKSIGJENI
					QË JETON NË UË
RUMANIA	AKTORE AMERIKANE, NËNA E AKTORES NË FOTO				
	PJESËTAR I NJË POPULLI EVROPIAN				
E PARAQES, I BËJ RAPORT					TANTALI
KOMPANI PËR USHQIME FEMIJËSH					LËNG SYRI
					BELGIJKA
J					NJË E RESHUR



NE KËTË DITË

5 NENTOR 1963

ZGJIDHJET: H, D, KËTËJ, BANESA, RAJAN, KAPTIM, RU, A, DEMAJ, VIJORE, SOLNAN, REIS, TL, FAKTET, SR, SAMARIA, TEATRORE, O, R, KHOANA MUR, E RAPORTOJ, HUMANA, LOT, JASINI, BORA.

HOTELI I MAHNITSHËM NË FORMË KITARE

Një hotel i ri në formë kitare dhe i lartë 138 metra po ndërtohet në Florida. Fotot tregojnë se ky hotel ka marrë tashmë formë dhe është gati që të hapet verën e ardhshme. Por, si çdo projekt, ka persona që mezi e presin, duke thënë që do t'i japë shtysë të mëtejshme turizmit, por ka edhe nga ata që thonë se ky hotel është i shëmtuar dhe aq i madh sa mund të shikohet nga hapësira.



Ideja e çmendur” e “Apple: Iphoni juaj do të jetë një pasaportë!

“Apple” vazhdon të sjellë ide të reja me përparimin e teknologjisë por këtë herë nuk bëhet fjalë për një Iphone me parametra të reja apo ndonjë shpikje tjetër teknologjike. Ideja e kompanisë këtë herë është se telefonat celularë që ata kanë në treg mund të përdoren edhe si mjete indendifikimi duke dëshiruar që personalizimin e tyre ta kalojnë në një nivel të ri. Sipas “Apple” Iphone-t kanë potencial të përdoren si pasaportë me ndihmën e një patente të sigurt dhe përdorimin e “RFID”. Është një ide shumë interesante se si në pajisjen tuaj të celularit përveç fotografive apo këngëve të preferuara mund të keni edhe pasaportën tuaj virtuale.

Pasaportat do të përfaqësohen me një çip të ndërtuar që përmban të gjitha informacionet për një individ si në pasaportat që përdorim aktualisht. Kjo është një ide tepër inovatore por a është bindëse për njerëzit pasi shpesh herë dëgjojmë për vjedhjen e të dhënave nga maniakët e teknologjisë. A do të ishit të gatshëm të përdorin pasaportat në formatin e propozuar nga Apple?

Luftoni problemet e zezës me çokollatë të zezë

Një lajm i mirë për të gjithë të apasionuarit pas çokollatave. Sipas një studimi, konsumimi i përditshëm i çokollatës është i shëndetshëm për zemrën.

Ekspertët kanë thënë se njerëzit e moshës 18-69 vjeç që konsumojnë 100 mg çokollatë në ditë, i kishin më të ulëta insulinën dhe enzimën e mëlçisë. Insulina dhe enzimën e mëlçisë janë dy tregues që përcaktojnë rrezikun e sëmundjeve të zezës. Të apasionuarit pas çokollatave kanë shanse të jenë më aktivë dhe ka shumë pak shanse që të vuajnë nga problemet kronike shëndetësore.

Në një tjetër studim është zbuluar se



konsumimi i çokollatës të zezë rregullon funksionin e trurit, forcon kujtesën dhe jep aftësi më të mira në arsyetim. Domethënë në qoftë se konsumoni përditë çokollatë të zezë nuk do të keni probleme shëndetësore dhe do të jeni më të zgjuar.

Përdhunon dy djem të mitur, i moshuari nuk do shkojë në burg!

Kishte përdhunuar dy djem të mitura me moshë 10 dhe 14 vjeç, kur ishte 30 vjeç, dhe për këtë arsye pas thujse 60 vitesh, një i moshuar u dënua nga gjykata, por nuk do të shkojë në burg. “Tashmë është shumë plak dhe i sëmurë, dënimi është i kotë”, deklaroi gjyqtari gjatë dhënies së dënimit. Një histori padrejtësie dhe mizorie në të njëjtën kohë, e cila vjen nga Armagh në Irlandë. John Joe Kiernan, një burrë 86-vjeçar, u shpall fajtor për përdhunim, ndaj dy vëllezërve të mitur, gjatë viteve ‘50-’60,

Përdhunimi la gjurmë në jetën e dy vël-

lezërve, të cilët u rritën mes shumë vështirësish dhe me makthin e asaj që kishin kaluar, por që nuk gjetën kurajo të denoncin. John Joe Kiernan, edhe në të kaluarën ishte dënua për krime të tilla, ku në vitin 2005, u shpall fajtor për përdhunimin e tre djemve dhe një vajze përgjatë viteve 1963 dhe 1973.

Të mërkurën e kaluar ai u dënua sërish me 15 vite burg. Por për shkak të moshës së madhe dhe problemeve shëndetësore, pasi vuan nga diabeti dhe është operuar në zemër, gjyqtarët vendosën që të mos e ndëshkojnë me burg.



1492 - Kristofor Kolombo mëson në lidhje me misrin nga Indianët e Kubës.

1605 - Konspiracioni i Barutit: Katolikët mundohen të shkatërrojnë Parlamentin anglez. Konspiracioni zbulohet dhe udhëheqësi Guy Fawkes dënohet me varje.

1630 - Spanja dhe Anglia nënshkruajnë marrëveshje të paqes.

1725 - Spanja dhe Austria nënshkruajnë marrëveshje të fshehtë.

1811 - Lufta e parë e El Salvadorit kundër Spanjës për pavarësi.

1854 - Lufta e Krimesë: Britanikët dhe francezët mundin forcat ruse.

1911 - Italia sulmon pjesën turke të Afrikës Veriore (Libinë), merr Tripolin dhe Kirenakën

1912 - Trupat bullgare në Konstantinopojë bllokojnë ujin e pijshëm.

1913 - Ludwig III kurorëzohet mbret i Bavarisë.

1914 - Britania përvetëson Qipron.


1914 - Britania e Madhe, Franca dhe Rusia shpallin luftë Rusisë.

1956 - Britania dhe Franca zbarkojnë trupat në Egjipt.

1978 - Ithtarët e Homeinit sulmojnë Ambasadën britanike në Iran.

SËMUNDJA QË SHKAKTON 800 MIJË VIKTIMA NË VIT

Mungesa e hekurit në organizëm shkakton rreth 800 mijë të vdekur çdo vit. Sipas ekspertëve, anemia është e nënvlerësuar, pavarësisht se prek 25 % të popullsisë globale. Alarmi hidhet nga ekspertët e Organizatës së Mjekësisë së Brendshme në Itali, të cilët vlerësojnë se mungesa e hekurit në gjak nis që në vegjëli, rëndohet me kalimin e viteve dhe bëhet shumë e evidente në moshat mbi 65 vjeç. Në vitet e fundit është vrojtuar një rënie e nivelit të hemoglobinës tek të moshuarit që vuajnë nga sëmundjet kronike duke përfshirë shumë më tepër gjendjen e tyre. Siç dihet anemia bëhet burim për lindjen e sëmundjeve të tjera, kryesisht atyre kronike.



DËSHMITARI

Gjyqtari e pyet dëshmitarin:

- E di se çdo të fitoni me dëshmi të rrejshme?

- Po, e di. I akuzuari ma ka premtuar një automobil.



Është kënaqësi e dyfishtë të mashtrosh mashtruesin.

(Makiaveli)